

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7641 E martë 4 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Nuk ka diskutim se mjaft ndryshime, të kryera në rrjedhën e viteve në shkolla, po i përmirësojnë gjërat. Ndërsa shkollorë më të këndshme, të pajisura...
Vijon në faqen 20

Nga PËLLUMB KARAMETA
Për psikologë shkollorë dhe mësues më të mirë



Opinion *i* **Ditës**
Këtë vit, ndërsa laleshim në ujërat e kaltër të Jonit, nuk patëm pranë kokës zhurmat e motorëve të frikshëm të ujit të një viti më parë. As gjakosje ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Pse pushuam më qetë?



Ruçi: Të punojmë bashkë për integrimin
Kuvendi rinis me bojkotin e opozitës, Xhafaj: Në tetor do të godasim grupet e krimit
Taulant Balla: Të zbardhen vrasjet në Shkodër. Reforma, debat në Konferencën e Kryetarëve
Nga VALENTINA MADANI
Kuvendi i Shqipërisë nisi punën pasditën e djeshme, por në seancë mungoi opozita, e cila u mbledh po në të njëjtën orë në Shkodër për një mbledhje të jashtëzakonshme për shkak të situatës kriminale në kryeqendrën ...
Në faqen 3

NDRYSHON LIGJI/ GATI PAGESA PER 200 ISH-TE DENUAR QE ENDE JETOJNE TE PERNDJEKURIT, KOMPENSIM PER 13 MIJE TRASHEGIMTARE

Drejtori i Thesarit në Ministrinë e Financave shpjegon procedurën si do ndahen paratë: Plotësoni dosjen brenda 3 viteve, ndryshe humbisni të drejtën



(Në foto) Ish-të përndjekur

SOLIDARITETI
Plumbat në banesën e Klodiana Lalës, gazetari italian: Sulme burracakësh
Në faqen 9

NGJARJA NE LAÇ
Tritoli, pronari i lokalit kërcënon me armë gazetarin e tv "News 24"
Në faqen 9

DOKUMENTET
Ndërtimet para '91, nisin aplikimet, formulari për të kryer legalizimin
Në faqen 7

MBLEDHJA E OPOZITES
Basha në Shkodër: Marrëdhënie me kusht me Kuvendin. Rama, pakt me krimin
Në faqen 2

Dossier nga Dashnor Kaloçi/ Mesazhi sekret i Enver Halilit për Komitetin Qendror
Raporti: Bandat, Feçor Shehu urdhëroi tërheqjen
Sekretari i parë i Korçës: Ja kush ndërhyri për Thanas Andonin

Nga DASHNOR KALOÇI
Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe



sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutoheshin "nën ...
Në faqen 10-11

KONFERENCA NE TIRANE
Muxhahedinia me MEK: Endrra ime është liria e njerëzve të mi
Në faqen 8

PARLAMENTI DEBATI

Opozita mblidhet në Shkodër, kreu i PD: Kriminelët po terrorizojnë qytetin

Valentina Madani


Opozita vendos mar rëndënie të kushtë zuar me parlamen tin. Vendimi u mor dje në mbledhjen e jashtëzakonshme të opozitës në Shkodër. Në të njëjtën orë me zhvillimin e seancën plenare, opozita zhvilloi dje një mbledhje të jashtëzakonshme në Shkodër, aty ku sipas kreut të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, kriminelët kanë 6 muaj që po e terrorizojnë këtë qytet. Basha hodhi akuza të ashpra nga qyteti i Shkodrës, duke theksuar se krimi sundon jo vetëm në këtë qytet, por edhe në qytete të tjera të vendit. Sipas tij krimi ka kapur edhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe eksponentë të tjerë të rilindjes, siç e cilësoi ai. Kreu demokrat tha, gjithashtu, se prej 6 muajsh, bandat terrorizojnë qytetin e Shkodrës, duke shtuar se atje duhet të ishte sot Edi Rama për të lajmëruar arrestimin e tyre. "Në më pak se 3 muaj kanë ndodhur 6 vrasje mafioze dhe janë rrembyer 2 persona. Kjo është situata në Shkodër. Këtu duhet të ishte kryeministri, jo për të shitur mend dhe për të bërë batuta, por për të raportuar arrestimin e kriminelëve që kanë 6 muaj që terrorizojnë Shkodrën. Por Rama nuk mund të jetë këtu, është në Tiranë me Cjrbjen, Taulant Ballën e Fatmir Xhafajn", theksoi Basha. "Na bëjnë thirrje për bashkëpunim, por me kë të bashkëpunojmë? Me vëllain e Xhafajt? Apo me Taulant Ballën, që i plasi skandali i "Toyota Yaris"-it? Ai pohoi vetë që është mik me një nga anëtarët e bandës së Lushnjës, të dënuar për trafik droge", u shpreh kreu i PD-së. Më tej, kreu i PD-së theksoi: "Rama bashkëpunoi haptazi me familjen kriminale Bajraj që ka kthyer Dobracin në zonë lufte. Një lagje e Shkodrës e vënë nën kontroll nga bandat. Shteti është ulur në gjunjë të krimi. Rama-Xhafaj janë kryeministër dhe ministër në letër, por kontrollin e shtetit e kanë bandat. Ky është realiteti në Shkodër, Vlorë, Fier, Durrës dhe Shijak. Janë qëlluar gazetarë, janë rrembyer e zhdukur qytetarë e gazetarë. Situata është totalisht jashtë kontrollit, sepse shtetin e kontrollon krimi i organizuar". Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i bëri thirrje drejtorit të policisë së qarkut të Shkodrës që të japë dorëheqjen nga detyra, pasi në të kundërt sipas tij, do të jetë përgjegjës si Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj. Basha tha se policia e Shkodrës është gjuhëzuar përballë krimi. "Në gjuhë është edhe policia e Shkodrës. Sot kam

Marrëdhënie e kushtëzuar me Kuvendin, Basha: Gati platforma kundër krimi

Thirrje drejtorit të policisë Shkodër: Dorëhiq



AKUZA
"Si mund t'i kërkohet opozitës të ulet të bëjë ligje dhe reforma me Fatmir Xhafajn që duhet të ishte nën hetim nga ligji antimafia. Si mund t'i kërkohet opozitës të negociojë me Taulant Ballën e "Toyota Yaris", i cili pranon publikisht se ka mik një trafikant droge", - theksoi kreu i PD.



Tryeza e djeshme e opozitës së Bashkuar në Shkodër

KRIMI
"Për pushtetin e tij, Edi Rama bëri pakt me kriminelët nga jugu në veri nga lindja në perëndim. Për pushtetin e tij, u hapi rrugë kriminelëve në polici. Kaluam nga një ministër i Brendshëm që bënte vetë drogën, tek një ministër i Brendshëm që bën drogën me vëllain e tij", - tha Basha.

"Sesioni i ri parlamentar nis me konflikt"

Paralajmërimi i Vasilit: Opozita përballje frontale me mazhorancën



e Shqipërisë. Të rinjtë e Shqipërisë po përballen me një qeverisje të rrembyer nga hajdutët. Papunësia është një plagë që thellohet dhe kontraktohet nga shifrat e turpshme që dalin nga qeveria. Dhuna dhe arroganca kanë qenë ato që shënjon se

VENDIMI
"Grupi i deputetëve të PS sot hapi një kuvend duke demonstruar si një grup deputetësh kuslingë, grabitqarë, armiq të popullit dhe kundra popullit. Opozita ka vendosur që marrëdhënia me parlamentin të jetë e kushtëzuar. Të ketë një qëndrim të papajutëshëm dhe zero kompromis me një qeverisje të kriminalizuar", - deklaroi z.Vasili.

Kreu i grupit të LSI, Petrit Vasili u shpreh se ky sesion i ri parlamentar do të nisë sërish me konflikte, ashtu siç u mbyll. Vasili tha se si vetmi instrument është përballja balllore me mazhorancën. "Ky sesion fillon me të njëjtën shenjë të konfliktit. Instrumenti i vetëm është përballja balllore me mazhorancën. Rivendosja e shtetit ligjor duke rimarë reformën në drejtësi, pasi vetingu nuk funksionon. Ne jemi të gatshëm për të rindërtuar reformën në drejtësi", deklaroi z.Vasili. Ai përmendi se LSI ka një moto të vetme këtë sesion, se do të ketë tolerancë zero kundër atyre që grabisin vendin. "Arsyeja pse i ka duart e lidhura është e thjeshtë dhe e qartë, pasi ka qenë njësh me kriminelët. Janë kriminelët ata që diktojnë punën në komisarariat e Shkodrës. Ndërsa shteti nuk është, është në një cep. Kjo situatë kriminale ka rënëruar dhe ekonominë dhe po largon të rinjtë

një thirrje për drejtorin e qarkut të Shkodrës; jep dorëheqjen dhe largohu menjëherë për ndryshe do të jesh njësoj përgjegjës si Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj për këtë gjendje. Në qoftë se nuk ta mban të thuash të vërtetën, nëse nuk guxon të mobilizosh Policinë e Shtetit kundër

kriminelëve, përkundrazi i shoqëron ata me blinda dhe furgonë policie, atëherë e vetmja që të shpëton nga përgjegjësia morale dhe penale është largimi yt dhe i çdo oficeri jetë që nuk zbaton dot ligjin dhe nuk shtyp dot krimin për një arsye të thjeshtë sepse krimi ua ka marrë

kalanë nga brenda", deklaroi z.Basha. Në krye të Policisë së Shkodrës aktualisht është Vehbi Bushati me një karrierë të gjatë në polici. Z.Basha foli për një platformë për t'u përgjigjur situatës me krimin në vend. "Në këtë përpjekje, PD nuk ka e s'mund të ketë axhendë përveç shtypjes e

çmontimit të krimi. Detyra jonë t'i bëjmë ata të tundin pizhamet me vija prapa hekurave dhe para drejtësisë. Detyra jonë është të gjejmë rrugët, aksionin dhe platformën politike për t'i dhënë fund kësaj gjendje dhe për t'i dhënë vendim siguri rend dhe demokraci", -tha kreu i PD-së.

Basha: Duhej të ishte në Shkodër, Rama: Rrotullohesh në gjumë

Kryeministri Edi Rama iu përgjigj dje me ironi akuzave të forta të kreut demokrat Basha nga qyteti i Shkodrës. Rama reagoi shkurtimisht në rrjetet sociale, duke shkruar se "s'kemi ç'i bëjmë, duhet të bëjmë dhe pa të". "Kur duhet të jetë në Tiranë, shkon në Shkodër. Kur duhet të hyjë në zgjedhje, futet në çadër. Kur duhet të shkojë në punë, rrotullohet në gjumë. Kur humbet, shpall fitoren. S'kemi ç'i bëjmë, duhet të bëjmë dhe pa të. E gjithë Vëmendja te njerëzit", shprehet z.Rama. Gjatë takimit të opozitës në Shkodër, Basha tha se kryeministri duhet të ishte në qytetin verior për të lajmëruar arrestimin e bandave të krimi që kanë marrë peng këtë qytet. "Këtu duhet të ishte kryeministri i Shqipërisë për të raportuar arrestimin e kriminelëve që terrorizojnë prej 6 muajsh qytetin e Shkodrës. Edi Rama është në Tiranë me Jurges Çyrbjen, me Taulant Ballën, me Fatmir Xhafajn dhe shumë eksponentë të tjerë të faktuar si persona të lidhur me krimin e organizuar. Kjo është arsyeja e dytë se pse opozita mblidhet këtu", deklaroi kreu i PD-së.



Punimet nisin me bojkot, Ruçi: Ndalni luftën për pushtet, të punojmë për integrimin

Kuvendi nis me bojkot, Xhafaj: Në tetor godasim grupet kriminale

Balla: Vrasjet në Shkodër duhen zbardhur

Valentina Madani

Kuvendi i Shqipërisë nisi punën pasditen e djeshme, por në seancë mungoi opozita, e cila u mbledh po në të njëjtën orë në Shkodër për një mbledhje të jashtëzakonshme për shkak të situatës kriminale në kryeqendrën e verit. Në fjalën hapëse, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi deklaroi se partitë politike duhet të luftojnë për qëllimin e përbashkët: integrimin e Shqipërinë në Bashkimin Europian. "I ftoj të gjithë që të ndajnë luftën e pushtetit nga lufta e përbashkët për integrimin në Europë. Integrimi do të jetë objektiv i pandryshuar i Kuvendit", theksoi Ruçi. Në fjalën e tij, Ruçi përmendi edhe reformën në drejtësi duke u shprehur se ajo do të garantojë zbatimin e të drejtave të qytetarëve. "Fakti që 56% e gjyqtarëve u shkarkuan tregon që kjo ishte një domosdoshmëri për këtë sistem. Mosmiratimi i ligjit për magistratët tregon se dakordësia nuk u mbështet nga ana e opozitës. Kemi rastin që ta korrigjojmë në këtë sistem të ri parlamentar. Nuk është në dorën e Kuvendit apo qeverisë për t'i dhënë të drejtën qytetarëve. Qëllimi i reformës është garantimi i zbatimit të të drejtave të qytetarëve. Brenda këtij sesiioni duhet të finalizohet ngritja e organeve të reja të drejtësisë. Këshilli për legjislativon nuk përmbushi detyrën ndaj 5 vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kostot e reformës cilado qofshin jemi të dënuar t'i shërbejmë interesit publik. Ftoj të gjitha grupet politike që të ndalnin luftën për pushtetin e radhës, betojnë e përbashkët është për integrimin në Europë", deklaroi kreu i Kuvendit.

PARALAJMËRIMI
Në seancën e parë parlamentare për këtë sesion, foli edhe ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj. Pas vrasjeve të ndodhura së fundmi në Shkodër, që tronditën mbarë opinionin publik, Xhafaj paralajmëroi se do të shkojë deri në fund këtyre çështjeve. Ai paralajmëroi se shumë shpejt do përgjigjet të gjithë ekzekutorët. "Hetimet për rastet e Shkodrës po zhvillohen me intensitet. Gjatë mandatit të tyre të parë qeverisë, në vend u regjistruan 230 vrasje me dashje, 58 çdo muaj, ndërsa në tonin vetëm 48 vrasje. Në Shkodër, në mandatin e parë ata



GODITJA
"Jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë time. Jemi në luftë intensive me grupet kriminale. Kemi bërë skanim e profilin të tyre. Goditëm një pjesë në muajt shtator-tetor në sajë të provave që kemi mbledhur do të godasim edhe një pjesë tjetër të mirë të këtyre grupeve", deklaroi z.Xhafaj.

Debate në Konferencën e Kryetarëve

'Drejtësia', Spaho: Reforma çoi sistemin në kaos, 6 ligjet të rishkruhen

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi mbledhi dje kryetarët e grupeve, pak orë para nisjes së seancës plenare. Një pikë e nxehtë gjatë diskutimeve në Konferencën e Kryetarëve ishte reforma në drejtësi. PD dhe LSI kërkuan që 6 ligjet e reformës në drejtësi të rishkruhen. "Ngrita çështjen e reformës në drejtësi që ka dështuar. Jemi pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë, pa Gjykatë të Apelit, pa KLGJ, pa KLP, pa KED. Për 11 gjyqtarë dhe prokurorë ONM ka ngritur pretendime serioze për mosplotësimin e kriterëve të vetingut. Sa i takon zgjidhjes, PD që në 2016 ka paraqitur propozimin që sikurse u miratua Kushtetuta me konsensus edhe 7 ligjet e reformës në drejtësi të miratohen me konsen-



sensus. Vetëm një u miratua me konsensus. Së fundi kemi propozuar rishikimin e pakëtës së 6 ligjeve, nuk mund të zgjidhim vetëm me Shkollën e Magistraturës. Kandidatët duan 2 vite të mbarojnë shkollën dhe niveli i njohurive të tyre dhe eksperiencën e punës nuk është e atillë sa të punojnë në organe kaq të rëndësishme",

DENIGRIMI
"Solla në vëmendje edhe sulmin ndaj gazetares Klodiana Lala, që është pika kulmore e asaj politike konstante që ka ndjekur kryeministri Rama në denigrimin, poshtërimin, luftën e ashpër që ka ushtruar gjithmonë ndaj përfaqësuesve të medias, shtypit, që nuk kanë qenë në unison me qëndrimet e tij politike", tha Edmond Spaho.

tha z.Spaho. Ulisi Manja i PS-së tha se deputetët e opozitës iu dukën sikur vinin nga dasma. "Mua m'u duk sikur ishin deri në vonë në ndonjë dasmë, meqenës ishte dhe ditë e diel. Jemi për zbatimin deri në fund të reformës në drejtësi, siç ka paraparë Kushtetuta dhe ligjet e vendit", u shpreh z.Manja.

Krahasuar me një shifër 8 vrasje gjatë tetë muajori janar-gusht 2018. Edhe gjatë 2012 ka qenë një numër i lartë 18 dhe mesatarja ka qenë 15 vrasje në mandatin e dytë dhe të fundit të PD krahasuar me një numër 9 mesatarja gjatë mandatit tonë të parë. Vrasjet në Shkodër duhen zbuluar dhe ndëshkuar menjëherë dhe sa më parë. Zoti Ministër i Brendshëm, me kemi besim te puna juaj dhe e policisë dhe presim menjëherë reagimin, sa më të shpejtë dhe të fortë, një përgjigje kuptim plotë ndaj kujtdo që ka gisht në shqetësimin e qytetarëve shkodranë", deklaroi z.Balla.

"SHKARKOHET DREJTORI I SHISH"

Berisha: Hakmarrje e Ramës se dekonspiroi Ballën tek opozita

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se është shkarkuar nga detyra drejtori i SHISH, Gentjan Lleshi, me urdhër të Edi Ramës, lëvizja kjo që sipas Berishës vjen në formë hakmarrjeje pasi Lleshi kishte njoftuar opozitën për Taulant Ballën si pritisë të 5 milionë lekëve të drogës nga 'Toyota Yaris'. "Noriega shkarkon drejtorin në SHISH si hakmarrje për Taulant Bega/Yaris/Hoxha/Gjura/Jashari! Te dashur miq, Sigurimi i Shtetit në krye të SHISH shkarkon, me urdhër të Ramës nga detyra, pas një procesi terrori të gjithanshëm psikologjik dymujor, kryetarin e degës së këtij institucioni Gentjan Lleshi me akuzën, absolutisht false, se njoftoi opozitën për Taulant Ballën si pritisë i 5 milionë euro para droge me 'Toyota Yaris'. Burime të brendshme bëjnë me dije se nuk ekziston asnjë provë, fakt apo e dhënë se Gentjan Lleshi ka komunikuar kurrë me njeri për atë problem. Por dihet se drejtori në fjalë është dhe një nga kontributorët kryesorë të raportit të Shërbimit Informativ për angazhimin direkt të 127 oficerëve të lartë të policisë në kanabizimin e Shqipërisë dhe rolin direkt të Saje qorrit dhe vetë Norieges në këtë proces! Duke dënuar me ashpërsinë më të madhe aktin hakmarrës primitiv të Edvin Kristaq Ramës ndaj drejtuesit të rëndësishëm të shërbimit inteligjent të vendit, paralajmëroj atë dhe xhelatët e Sigurimit të Shtetit në krye të SHISH se do paguani shtrenjtë veprimin tuaj banditesk, antiligjor me të cilin ju hakmerreni për të mbuluar lidhje tuaja të tmerrshme të krimi"-, shprehet z.Berisha.

SHPLLJE ANKANDI

Datë 06.09.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cui 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e palajshme të debitorit Luan Zef Pali dhe dorëzueses Loreta Fletri Pali:
"Apartament" me sipërfaqe 88.9 m2, nr1 pasurisë 4/1624-1-12, zona kadastrale B631, vol. 6, faqe 20, adresa: Rruga "Gurra", pallati 138, shkalla 1, apartamenti 12, Lezhë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 2 419 984 (dy milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.
Ankandë do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

QEVERISJA LEVIZJET

Ndryshime në qeveri? Balla: Shënim emrat e ministrave që nuk ishin në turin e llogaridhënies

Slogani i fushatës së PS-së: E gjithë vëmendja te njerëzit

Anëtarët e grupit strategjik për zgjedhjet

Partia Socialiste zhvilloi dje mbledhjen e Kryesisë ku u diskutua për një sërë çështjesh të rëndësishme. Një prej pikave më të rëndësishme të diskutuara ishte edhe përmbyllja e turit të llogaridhënies. Kreu i deputetëve socialistë Taulant Balla deklaroi se është hartuar një raport për çdo njësi vendore me problematikat dhe punën e kryer. Ai paralajmëroi edhe ministrat që nuk kanë marrë pjesë se gjithçka është mbajtur shënim. "Në radhë të parë ishim të fokusuar në një raport për turin e llogaridhënies, në çdo njësi të Shqipërisë, ku kishim mbajtur gjithçka shënim, edhe ministrat që nuk morën pjesë. Do nisim një fushatë të re anëtarësimesh, në përgatitje të zgjedhjeve vendore të vitit të ardhshëm. Ne jemi të fokusuar në një proces më të hollësishëm dëgjesash, ku kryetarët vendorë, apo anëtarët e këshillave bashkiakë do rikthehen në çdo komunitet për të dëgjuar e mbajtur shënim, sepse për ne është shumë e rëndësishme të kemi vëmendjen te njerëzit", tha Balla. Ai po ashtu u shpreh se PS mbetet e hapur për dialog me PD për çdo çështje. "Ne nuk mund të humbim kohë me tri konferenca për shtyp të PD në ditë me shpifje, ne e kemi vëmendjen te ata që na kanë votuar. Por, për ne dialogu me opozitën është thelbësor. Për shpifjet nuk japim dot përgjigje, për çështjet e tjera ofrojmë dialog konstruktiv", deklaroi Balla. Ai tha më tej se "Kemi marrë miratimin e Kryesisë për të reformuar Sekretariatën për një organizim më të mirë elektoral". Po dje Kryesia e PS-së miratoi grupin strategjik për zgjedhjet vendore të 2019 të kryesuar nga Blerina Gjylameti, e cila do të jetë edhe sekretare për organizimin e elektoral dhe drejtues politike e Tiranës. Ndërkohë anëtarët e grupit strategjik për zgjedhjet do të jenë Damian Gjikhuri, Ditmir Bushati, Bledi Çuçi, Erion Veliaj, Gramoz Ruçi dhe Taulant Balla.



Mbledhja e djeshme e Kryesisë së PS-së

GRUPI I PUNËS

Kryesia e PS-së miratoi grupin strategjik për zgjedhjet vendore të 2019 të kryesuar nga Blerina Gjylameti, e cila do të jetë edhe sekretare për organizimin e elektoral dhe drejtues politike e Tiranës. Ndërkohë anëtarët e grupit strategjik për zgjedhjet do të jenë Damian Gjikhuri, Ditmir Bushati, Bledi Çuçi, Erion Veliaj, Gramoz Ruçi dhe Taulant Balla.

zgjedhjet vendore 2019. Në axhendë zbulohet edhe slogani i PS për zgjedhjet e ardhshme lokale, që do të jetë "E gjithë vëmendja tek njerëzit". Pas miratimit të strategjisë "Partia Socialiste për ty", axhenda mbyllet me

diskutimin mbi të drejtën e votës për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit dhe unifikimin e regjistrat digjital të PS. Ndërkohë që të premtën e 7 shtatorit në mbledhjen e Asamblesë Socialiste, Edi Rama do të

shpallë vendimin nëse do të bëjë ndryshime në qeveri, apo do ta vijojë këtë vit të dytë të mandatit të dytë me të njëjtin ekip. Gjatë kohës që në Pallatin e Kongreseve dje po zhvillohej mbledhja e kryesisë së PS-së, kryeministri Edi

Rama, ka postuar një foto në profilin e tij në 'Insta Story'. Rama tregon në videon e shpërndarë prej tij, disa nga pikat e rendit të ditës, të cilat i shoqëron me dëfturë: "Kryesia e PS, live".



Protesta për Teatrin

Bushati takon Netanyahu në Izrael: Bashkëpunim për sigurinë në rajon

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë Ditmir Bushati zhvilloi një takim me kryeministrin, njëherësh ministrin e Jashtëm të Izraelit Benjamin Netanyahu. Gjatë këtij takimi bashkëbiseduesit u ndalën në çështje të rëndësishme të bashkëpunimit dypalësh, zhvillimit në fushën e sigurisë në lindjen e mesme dhe në rajonin e Ballkanit, lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja kibernetike. Ministri Bushati e njohu kryeministrin Netanyahu me zhvillimet në rajon dhe me rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti. Nga ana e tij, kryeministri Netanyahu vlerësoi gasjen e Shqipërisë ndaj sfidave të sigurisë në rajon dhe më tej, si dhe shprehu interesin e Izraelit për të forcuar më tej bashkëpunimin në këtë fushë. Ministri Bushati dhe Kryeministri Netanyahu diskutuan gjithashtu, për mundësinë e bashkëpunimit në fusha me interes reciprok si inovacioni, ekonomia, arsimi, kultura, etj. Gjatë vizitës së tij në Izrael, ministri Bushati do të zhvillojë disa takime bilaterale, si me ministrin e Mbrojtjes Avigdor Lieberman, ministrin për Bashkëpunimin Rajonal Tzachi Hanegbi, lideren e opozitës Tzipi Livni, drejtuesit e Komitetit Amerikano-Hebre (AJC) David Harris dhe Kongresit Botëror të Hebrejve (WJC) Robert Singer.

AXHENDA E ASAMBLESË SË PS TË PREMTEN

1. Raport Kombëtar i Llogaridhënies Publike të qeverisë "Puna për Shqipërinë që duam".
2. Raport i Grupit të Punës së Asamblesë Kombëtare të Partisë "Mbi performancën e përfaqësuesve të PS në qeverisjen vendore".
3. Udhëzimi për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillave Bashkiakë për zgjedhjet vendore 2019.
4. Raporti Kombëtar i Bashkëqeverisjes deri më 31.08.2018.
5. Raport mbi punën e Grupit Parlamentar të PS në dy sesionet e para të legjislaturës së IX.
6. Informacion mbi punën e strukturave vendore të partisë në raport me axhendën politike vjetore të partisë.
7. Udhëzimi për fillimin e fushatës kombëtare "E gjithë vëmendja tek njerëzit".
8. Miratimi i strategjisë "Partia Socialiste për ty".
9. E drejta e votës për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit.
10. Vendim për unifikimin e regjistrat digjital të PS.

Kryeministri: Asnjë nxënës pa libra me 17 shtator

Librat falas, Rama: Nisma përfshin edhe fëmijët e klasave të 9-a



“POROSIA

"Pakot me libra duhet t'u shkojnë fëmijëve dhe prindërve në dorë para fillimit të vitit të ri shkollor. Nuk është aspak e këndshme qoftë edhe një familje sikur të mbetet pa marrë libra", -tha z.Rama.

një lloj pengese. E njëjta gjë vlen dhe për fëmijët në kategori të tjera. Pakot me libra duhet t'u shkojnë fëmijëve dhe prindërve në dorë para fillimit të vitit të ri shkollor. Nuk është aspak e këndshme qoftë edhe një familje sikur të

mbetet pa marrë libra", deklaroi z.Rama. Kryeministri pati një përgjigje edhe për shtrënjtimit e disa prej librave shkollorë, ndërsa shprehu angazhimin se deri në fund të mandatit librat do të jenë falas deri në klasën e 9. "Sot

mbyllim ciklin e nisur nga ministrja për zëvendësimin e librave skarco me libra të 'Kembrixhit', 'Oksfordit', libra me cilësi të padiskutueshme. Janë këto libra që sot jepen falas nga klasa e parë deri në të katërtën. Disa thonë janë shtrenjtura, po disa libra janë pak më të shtrenjtë se ishin, sepse janë produkte shumë më cilësore. Nëse bëjmë krahasimin me vendet e tjera nuk ka asgjë anormale. Por ajo që duam të bëjmë është se deri në fund të mandatit t'i bëjmë falas komplet deri në klasën e 9. Besoj se do t'ia arrijmë", u shpreh kryeministri Rama.

ASAMBLEJA

Asambleja Kombëtare e PS-së, ditën e premte do të nisë me një raport llogaridhënie të qeverisë dhe bashkëqeverisjes, ndërsa do të vijojë me një tjetër raport mbi performancën e përfaqësuesve të PS (kryebashkiakëve) në qeverisjen vendore. Gjithashtu, do të nisë procedura për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillave Bashkiakë për



Mazhoranca shtyn shembjen e Teatrit

Manja: Dekreti i Metës diskutohet më 20 shtator, Spaho: Sillni ligjin në Kuvend

Konferenca e Kryetarëve nuk pranoi dje tërheqjen e ligjit për Teatrin Kombëtar, siç e kërkoj opozita, por vendosi ta shtyjë me një javë dekretin e Presidentit Meta, i cili e konsideroi projektin antikush-tetues. Pas kërkesës së kreut të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Eduard Shalsi, që është edhe komisioni përgjegjës, u vendos që dekreti të diskutohet në 20 shtator. Ndonëse kreu i opozitës Lulzim Basha i përcaktoi Ramës se "vija e kuqe" është shembja e Teatrit Kombëtar, mazhoranca bën lëvizjen taktike duke shtyrë dekretin e presidentit për më 20 shtator. Lajmi u bë i ditur fillimisht nga Eduard Shalsi e më pas nga kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja. "Një ndër priligjet e rëndësishme që përbën dhe sensibilitet është



dhe dekreti i presidentit. Meqë është depozituar gjatë kohës që Kuvendi ishte shpërndarë u kërkua nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, që ky dekret të mos jetë në datën 13 shtator,

por atë të datës 20 pasi komisioni, përgjegjës ka nevojë për kohë për të hartuar relacionin përgjegjës. Këtë vendosi Konferenca e Kryetarëve", deklaroi Ulsi Manja. Sipas tij, deputetët duhet të marrin pak

kohë për t'u njohur me argumentet e presidentit për të mos e dekretuar këtë ligj. Por kreu i deputetëve të PD-së Edmond Spaho i kujtoi edhe njëherë paralamërimin e Bashës. "Urova që mazhoranca të ketë kurajën të sjellë ligjin në Kuvend, të miratojë dekretin dhe të rrezojë ligjin. Nëse nuk e kanë këtë vullnet, të kenë parasysh që, siç tha Basha, me veprimet e tyre do ta çojnë vendin në një situatë ku paqëndrueshmëria politike do të jetë tipari kryesor i raporteve mes mazhorancës dhe opozitës", theksoi Z. Spaho.

Protestuesit: Tani fillon beteja e vërtetë, po zbrazet Teatri Kombëtar

Budina: Do i detyrojmë të tërhiqen nga ligji me turp

Çipi: Na provokuan, deshën incidente

Fatmira Nikolli

Pra disa ditësh Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit fotografoi një furgon pranë godinës së Teatrit Kombëtar dhe u shpreh se po merreshin prej aty objekte të TK-së për t'i dërguar te "Turbina", qendra e artistike që po planifikohet të strehojë Teatrin Kombëtar. Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Teatri Kombëtar të Operës dhe vetë skenën e pavarur. Po ditë më parë, dritat e Teatrit Kombëtar u shuan, ndërsa aktorë që kanë hyrë brenda flasin për salla e korridorë të braktisura, për një skenë të trishtë ku nuk pipëtin më asgjë e për një ambient ku tanimë pluhuri i ka zënë vendin jetës (artistike). Ata mundën të shohin se si shuhen dritat e një teatri. (Përkrah tij, ende qëndron TKE-i Iyer, i mbajtur në këmbë e ende në jetë). Në një anë tjetër të Tiranës, gumëzhijnë zërat e ikur-aty ku një godinë me pluhur, të pajetë e të harruar iu dha shkëlqimi i një qosheje arti.

Kanë kaluar më shumë se 80 ditë proteste të përnatshme për mbrojtjen nga shembja të dy teatrove kombëtarë dhe prapë ligji që i hap rrugë shembjes së tyre për të ndërtnuar një të ri me PPP është çështje dite. Dje



Regjisori Robert Budina

një deklaratë e mazhorancës bëri me dije se votimi i dekretit të presidentit që e ktheu ligjin për rishqyrtim nuk do të votohet në datën 13 shtator, por 7 ditë më pas, më 20 shtator. Si fillim, mes artistëve që kërkojnë tërheqjen e ligjit dhe restaurimin e godinave, shtyrja me një javë u pa si fitore, megjithëse zor se ka elemente që e nxjerrin të tillë. Kur letrat u lexuan siç janë,

u vu re se nga shtyrja me 1 javë të tërheqja është një distancë e madhe. Të pyetur nga "Gazeta Shqiptare" për këtë shtyrje dhe për hapat që do ndërmarrin, përgjigjet qenë të ndryshme.

REAGIMET

Regjisori Robert Budina i pranishëm të 80-a metë në sheshin e protestës e të lirisë, tha se kryesorja është që qëndresa jonë i dha frytet e veta të para. "Fillimisht re-



Regjisori Kastriot Çipi

aguan ndërkombëtarët pastaj e ktheu presidenti, e më pas besoj se kryeministri është i trembur që peshorja po anon fort nga krahu ynë, krahu i së drejtës, pra po kupton që ai po e humb popullaritetin, pra po humb votat ndryshe nëse nuk do të ishte kështu nuk do tërhiqej, mjafton të kujtosh presionin që i bëri ish-kryeministri Majko në parlament kur ai nuk e votoi ligjin", - tha Budi-

na. Sipas tij, ky është një mesazh i fortë shprese për njerëzit, të cilët duhet të kuptojnë se përballë një klase të pandërgjegjshme politike duhet të dalësh vazhdimisht në protestë për të fituar të drejtat e tua. Për të nuk ka rrugë tjetër. "Por tani fillon beteja e vërtetë për ne, sepse, nëse ata nuk tërhiqen, do të thotë që do ta lënë teatrin të rrënohet, pra ende nuk ka përfunduar. Ne do t'i dety-

rojmë të tërhiqen madje me turp nga ky ligj", përfundoi Budina për "GSH".

Më i ashpër është Kastriot Çipi në reagimin e tij. "E interpretoj si zbythje nga një provokim, sepse i tillë ishte. Lajmi i 'rrjedhur' në media për datën 13 nuk ishte i vërtetë. E thashë pardje. Ishte provokim për të nxitur përshkallëzim nga ana jonë, mundësisht incidente në teatër, mes aktivistëve dhe punonjësve të TK (ende jo të TKE) që po zhvendosin mjete pune e orendi drejt Turbinës. Natyrisht po zhvendosim ato që duhen për realizimin e repertorit te Turbina. Kjo është normale", tha Çipi që ka qenë mjaft aktiv në mbrojtjen e godinave që nga elemente pro shembjes janë quajtur stalla. Për Çipin, nuk ka ende prova se po zbrazet Teatri Kombëtar, por zbrazje do të thotë çmontim i infrastrukturës, pajisje skenike, të prodhimit dhe administratës. Nga ana tjetër, aktori Neritan Liçaj thotë se e ka të qartë që ndjeshmëria për teatrin është shumë e fortë dhe (ai) di që se fiton dot atë betejë. "Sigurisht që protesta do të vazhdojë, sepse nuk është më një protestë vetëm për teatrin, është protestë qytetare kundër kësaj qeverisjeje të papërgjegjshme tashmë", - shtoi ai.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartimorë L.D.C
 -Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m², ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar për shitje është 4.700.000 Leke.
 Data e shpalljes 01.08.2018
 Data e zhvillimit 05.09.2018 deri ne oren 16.00
 Ankandit zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimorë L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartimorë L.D.C
 -"Apartament", me sip. 69.2 m², Nr pasurie 10/158+2-1, Z. K 8631, vol. 9, fq 80, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1 Lezhe. Prona është e regjistruar pranë Z.V.R.P.P Lezhe, ne emert te Lulzim Kros Beqiri. Çmimi i ri per shitje është 2.170.000 Leke.
 Data e shpalljes 06.08.2018
 Data e zhvillimit 11.09.2018 deri ne oren 16.00
 Ankandit zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimorë L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Permbartuesi Gjyqësor Privat Cezar Beja
 Administrative Manex, Bashkia Durres
 Çmimi ne ankandin e dyte është 2.534.400 leke
 2.Liqji ipronës "ARE", Nr Pas 38/33, ZK 3137, Vol 5, Fq 82, Sip 2590m², Adresa Rade, Njesia Administrative Manex, Bashkia Durres
 Çmimi ne ankandin e dyte është 4.316.400 leke
 Ankandit do te zhvillohet ne zyran e permbartuesit gjyqësor privat Cezar Beja ne daten 20.09.2018 duke u mbyllur ne oren 16.00

ISH-TE PERNDJEKURIT DEMSPERBLIMET

Ndryshon ligji për ish-të përndjekurit politikë, gati pagesa për 200 ish-të dënuar

Omela Manjani

Rreth 200 ish-të dënuar politikë që jetojnë do të marrin paratë dëmshpërblimit shumë shpejt, duke mbyllur në këtë mënyrë pagesat për të gjithë këtë kategori. Ndërsa 13 mijë trashëgimtarët e ish-të dënuarve të regjimit komunist do të përfitojnë së shpejti dhe në shumë deri në 1 milionë lekë dëmshpërblimin. Qeveria ka miratuar disa ndryshime ligjore në ligjin për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë duke përshtatur atë me një realitet të ri. Duke qenë se kompensimi i ish-të burgosurve të mbetur ende gjallë po shkon drejt përfundimit, tashmë fondet e buxhetit do të fokusohen te trashëgimtarët. Drejtori i thesarit në Ministrinë e Financave sqaron se janë 200 persona ish-të dënuar që jetojnë, të cilët pritet të marrin kështu e fundit. Sa i përket dosjeve të trashëgimtarëve ato llogariten në afro 13 mijë të tilla. Pjesë e ndryshimeve është edhe fakti se kush përfiton deri 1 milionë lekë dëmshpërblim, tashmë do t'i marrë ato me një kësht të vetëm. Por ministria duket se është tërhequr nga varianti fillestar për të frenuar kompensimet përtej brezit të parë të të afërmeve. Por në ligj është saktësuar se, nëse trashëgimtarët për një afat kohor prej tre vitesh nuk interesohen për të plotësuar dosjen, atëherë e drejta e kompensimit digjet dhe paratë i kalojnë buxhetit të shtetit. Drejtori i Thezarit në Ministrinë e Financave, Lavdërim Sahitaj shpjegon ndryshimet e fundit ligjore në lidhje me trajtimin financiar të ish-të dënuarve të regjimit komunist.

Qeveria ka miratuar në mbledhjen e fundit të projektligji që ndryshon procedurat e pagesës së dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë. Ku konsistojnë këto ndryshime? Janë 200 persona nga kategoria parësore, pra, ish-të dënuar politikë, të cilët janë gjallë dhe që presin të marrin kësht e fundit, dy ose tre

Trashëgimtarët, 13 mijë përfituesit që do të marrin dëmshpërblimin

Nëse përfituesit nuk plotësojnë dosjen brenda 3 viteve, humbasin të drejtën



Drejtori i Thezarit në Ministrinë e Financave, Lavdërim Sahitaj

DEMSPERBLIMI

Familjarët e viktimave, të pushkatuara apo të ekzekutuara me dënim politik të padrejtë, për vuajtjen dhe persekucionin, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë, gjithsej, në masën e 8 viteve kompensim dënimi me burgim. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.

kësht. Më pas fondi do të çelët për gjithë dhe pagesa do të kryhet në mënyrë proporcionale. Për trashëgimtarët kësht do të jenë më të shpeshta pasi marrin një pjesë më të madhe të fondit. Sa është numri i trashëgimtarëve që presin të marrin paratë? Janë 13 mijë trashëgimtarë që presin të marrin dëmshpërblimin. Kush ka më pak se një 1 milion lekë të reja dëmshpërblim do t'i marrin ato menjë kësht

të vetëm dhe jo më të ndara. Si të do të ndahet fondi që vë në dispozicion buxhetit i shtetit?

Deri tani fondi është ndarë 70 % për pagesat e kategorisë parësore dhe 30 % për trashëgimtarët. Megjithatë pagesat për kategorinë parësore është drejt fundit, fondi do të shkojë për trashëgimtarët.

Ndryshimi i fondit? Ndryshimi parashikon që fondi që do të vihet në dis-

pozicion nga buxheti i shtetit do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, dhe jo si deri tani që fondi ndahet 70 % për kategorinë parësore dhe 30 % për trashëgimtarët. Në projektligjin që është miratuar në qeveri dhe do të kalojë për shqyrtim e votim në parlament thuhet se "Në nenin 12 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon: Paragrafi 1 parë ndryshon me këtë përmbajtje: "Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësht i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 milion lekë. Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 milionë lekë, do të vijohet me pagesën e kështit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit do të kryhet me një kësht të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit."

MASA E DEMSPERBLIMIT

Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:

- çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kritereve të këtij ligji, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë;
- për personat që kanë vuajtur internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është 1 000 (një mijë) lekë në ditë;
- për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Dëmshpërblimi i përcaktuar në paragrafin më sipër u takon dhe familjarëve të tij, në pjesë të barabarta takuese, kur i dënuari nuk jeton më. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake. Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.

unicef for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES

Subject: Support the MHSP to roll out the MIS for Social Care Services in Albania.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (www.unicef.org/albania) or UN Albania website (<http://www.un.org.al/employment-and-procurement>) to download the detailed TOR document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked: "TOR-ALBA-2018-015 - Support the MHSP to roll out the MIS for Social Care Services in Albania." to the address below:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel. +355 44548400; Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies must submit their application, not later than **13 September 2018, 16:30 hrs.**



SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT
NJJOFTIM

SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT FAF.Sh.A.

Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF – sha.kërkon të marrë me qera ambiente Zyre. Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF – sha është një institucion Financiar jo Bankë.

Referuar VKM Nr.521 datë 06.08.2014 kërkohej:

400 m² sipërfaqe për postë pune,
400 m² sipërfaqe ambiente të përbashkëta dhe ndihmëse,
6 vende parkimi.

Godina duhet të jetë open space,
Maksimumi i ndarjeve brenda godinës 8,
Kondicionimi i përqëndruar që garanton për 12 muaj temperaturën 23°C(+, - 2° C),
Ndrëqimi jetë 300 -700 luks,
Maksimumi i çmimit 5.5 euro/ m2 muaj, me taksa të përfshira.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit (355) 676030271, çdo ditë nga ora 9.00-16.00

"Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF" sh.a
Adresa: Rr. "Dervish Hima", nr. 4 Tirane. Tel/Fax: 355 04 2262027

Inspektorët e agjencive dhe inspektorateve të ndryshme gjithmonë kanë qenë në shënjestrën e akuzave për korrupsion, por një anketim i qeverisë nëpërmjet Ministrisë së Sipërmarrjes nxori në pah se 23 për qind e bizneseve kanë pohuar se iu është kërkuar rryshfet gjate procesit të kontrollit. Rryshfeti u është kërkuar për të mbuluar mungesën e dokumentacionit përkatës dhe mosplotësimin të kriterëve ligjore. Bizneset pohuan se 66.8% të rasteve inspektorët janë të pajisur me autorizimin përkatës, por në 33 për qind të rasteve ato nuk e kanë një autorizim kontrolli. Bizneset kanë pohuar se në 56.5% të rasteve inspektorët janë të prirur të vendosin gjopa apo

Anketa e qeverisë për shkallën e korrupsionit në Tatime

Rreth 23% e bizneseve pohuan se inspektorët kërkojnë rryshfet

të kryejnë pezullime. Gjithashtu, bizneset kanë pohuar se gjობat në shumë raste janë shumë të larta në raport me shkeljet e gjetura. Sondazhi i ministrisë u publikua në dhjetor 2017 duke shërbyer edhe si orientim për masat vijuese në funksion të përmirësimit. Qeveria tashmë ka nisur një proces reformimi të agjencive qeveritare dhe të gjitha inspektorateve dhe në këtë kuadër Ministria e Sipërmarrjes zhvilloi një pyetje

sor për biznesin, me qëllim mbledhjen e opinionëve tuaja rreth shërbimit të inspektorateve, ky anketës ju përgjigjen 587 biznese në të gjithë sektorët e ekonomisë. Qeveria synon që duke ofruar disa shërbime online të shmangë keqtrajtimin e qytetarëve dhe bizneseve nga kontrollet fizike të inspektorëve. Që nga ky vit 90 për qind e autorizimeve doganore të jepen online. Ky shërbim mund të bëhet nga shtëpia, madje edhe nga telefoni. Qever-

ia ka nisur një proces për të fshirë 10 licenca, teksa synon të eliminojë 142 dokumente, të cilat nuk do të kërkojnë më për asnjë shërbim të ofruar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë dhe institucionet e saj të varësisë. Gjithashtu, rreth 201 dokumente do merren drejtpërdrejt nga platforma elektronike të vete institucioneve publike, përmes ndërveprimit me platformën elektronike e-Albania, ose ndërveprimit dhe komunikimit me institu-



cionet publike përkatëse. Numri i shërbimeve që Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë aktualisht ofron, reduktohet nga 59 në 13 duke transferuar 46 prej tyre në institucione varësie apo palë të treta. Ndërkohë që e njëjta metodike është ndjekur edhe

për rastin e institucioneve të vartësisë ku reduktohet numri i shërbimeve nga 201 në 111 duke transferuar 90 prej tyre në palë të treta të akredituara për këto shërbime, ose organizata jo qeveritare apo dhoma të tregtisë e industrisë.

Janë 60 mijë ndërtime në të gjithë vendin që do legalizohen

Ndërtimet para vitit 1991, nis aplikimi, ja formulari

Dokumentet që duhet të dorëzojnë pronarët

Ornela Manjani

Personat që kanë ndërtuar para vitit 1991 dhe që nuk kanë dokument pronësie si për ndërtesën, ashtu edhe për truallin do të pajisen me tapi. Janë në total 60 mijë ndërtime në të gjithë vendin që do legalizohen. Pronarët e këtyre ndërtimeve duhet të paraqiten pranë ALUIZNI-t dhe të plotësojnë formularin-tip, i cili publikohet sot në "Gazetën Shqiptare". Aplikimet nisin brenda kësaj jave. Këshilli i Ministrave miratoi pak ditë më parë vendimin që i hap rrugë nisjes së procedurave, të cilat do të ndiqen nga ALUIZNI për pajisjen me dokument pronësie të këtyre pronave.

VENDIMI
Sipas vendimit, mësohet se ndërtime të ngritura deri më 10.8.1991 dhe trojet funksionale të tyre, për të cilat nuk ka akte të fitimit të pronësisë do të pajisen me tapi. Vetëm nëse për truallin ka dokumentacion pronësie, procedurat e kalimit të pronësisë kryhen vetëm për ndërtesën. Vendimi përcaktonte se do të konsiderohen objekt i trajtimit të këtij vendimi ato ndërtime: a) të cilave u mungon akti i fitimit të pronësisë; b) të cilat, nga pikëpamja ndërtimore janë të përfunduara, me mure dhe me mbulesë; c) të cilat nuk janë ndërtime pa leje, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të nenit 3, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e

ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Ndërsa truall funksional konsiderohet sipërfaqja e tokës nën ndërtesë, së bashku me oborrin përreth saj, që posedohet efektivisht nga subjekti kërkuar. Sipas këtij vendimi, ALUIZNI është institucioni i autorizuar për kryerjen e procedurave administrative. Kalimi i pronësisë së ndërtimeve dhe truallit funksional për sipërfaqet deri në 300 metra katrorë kryhet pa pagesë, nëpërmjet dokumentit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi. Procedurat e kalimit të pronësisë, sipas këtij vendimi fillojnë: a) me kërkesë të subjektit/subjekteve, sipas modelit të kërkesës së miratuar me këtë vendim, pavarësisht nëse zona kadastrale i është nënshtruar ose jo regjistrimit fillestar sistematik; b)

nga subjekti përfitues. Ndërkohë të dhënat e kërkesës dhe të evidentimit në terren bëhen publike për 30 ditë, në ambientet e njësisë administrative ku gjendet pasuria, në ambientet e ALUIZNI-t, ZVRPP-së si dhe në faqet përkatëse ueb. Si rregull, nëse për ndërtimin është aplikuar për legalizim si ndërtim pa leje, ai përjashtohet nga fusha e zbatimit të këtij vendimi dhe trajtohet sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Përjashtim bën rasti kur nga korrespondenca e ALUIZNI-t me organet kompetente (të vetëqeverisjes vendore dhe Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit - AQTN) apo nga dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi arrihet të provohet se ndërtesa është ndërtuar përpara datës 10.8.1991.

PËRCAKTIMI I SIPËRFAQES

Në përcaktimin e sipërfaqes, ALUIZNI bazohet në kufijtë faktikë të sipërfaqes së poseduar, pa tejkaluar masën prej 300 metrash katrorë.

1. Për procedurën e ndjekur, subjekti përfitues paguan për llogari të ALUIZNI-t tarifën e shërbimit në vlerën 8 000 (tetë mijë) lekë për çdo kat ndërtimi, e cila përdoret për të përballuar shpenzimet e evidentimit në terren dhe shpenzimet e tjera të procedurës administrative. Kjo tarifë i njoftohet përfituesit menjëherë pas përfundimit të periudhës së afishimit, nëse përmbushen kushtet për të përfituar kalimin e pronësisë, sipas këtij vendimi.
2. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet në favor të subjektit kërkuar dhe bashkëshortit/es së tij, duke respektuar dispozitat e Kodit të Familjes për regjimin pasurorë martesore. Në rast se subjektet nuk paraqesin dokument që provon regjimin pasurorë martesor të veçantë apo marrëveshje të posaçme notoriale për të drejtat miratuesen, vendimi miratohet në favor të të dy bashkëshortëve, duke prezumuar regjimin e bashkësisë ligjore. Për zbatimin e kësaj pike, ALUIZNI administron certifikatën familjare të kërkuarit, sipas mënyrës së përcaktuar në vendimin nr.332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formës, të elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet brenda 20 ditëve nga administrimi i vërtetimit për pagesën e tarifës së shërbimit, por në çdo rast jo më herët se data e përfundimit të afatit të njoftimit publik.
3. ALUIZNI brenda 10 ditëve nga miratimi i kalimit të pronësisë përcjell vendimin, së bashku me genplanin, për regjistrim pranë ZVRPP-së, e cila është e detyrues të kryejë regjistrimin brenda 10 ditëve nga administrimi i dokumentacionit.



NJOFTIM I ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE ANONIME KANTINA E PIJEVE "GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" SH.A

Njoftohen të gjithë aksionerët e Kantines së Pijeve "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sh.a se ne datën **05/10/2018, ora 10.00**, ne selinë shoqërisë me adresë ne **Rruga "Bajram Tusha" Lqj 14 - Rrëshbull - Durres** organizohet Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme me ketë rend dite:

1. **Emerimin kryetarit dhe anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyrës te shoqerise.**

Lutemi te merrni pjese ne mbledhjen e organizuar.

Të shtënat me kallashnikov mund të ishin kthyer në masakër

Vrasja e biznesmenit në Shkodër, si u rrezikuan 15 turistët kosovarë



Një plumb i armës kallashnikov shkon deri në 3 kilometër ndërsa aftësia shpuese është deri në 1.5 kilometër. Përveç rrezikut ndaj turistëve në këtë ngjarje ata sipas burimeve të organit të akuzës kanë dëgjuar edhe krizmat e armës në momentin kur autori ka qëlluar. Sapo kanë dëgjuar të shtënat shtetasit kosovar janë alarmuar ndërsa janë gjendur në vijë të drejtë me një sasi të konsiderueshme plumbash.

Një plumb i armës kallashnikov shkon deri në 3 kilometër ndërsa aftësia shpuese është deri në 1.5 kilometër. Përveç rrezikut ndaj turistëve në këtë ngjarje ata sipas burimeve të organit të akuzës kanë dëgjuar edhe krizmat e armës në momentin kur autori ka qëlluar. Sapo kanë dëgjuar të shtënat shtetasit kosovar janë alarmuar ndërsa janë gjendur në vijë të drejtë me një sasi të konsiderueshme plumbash.

ndonjërin prej tyre. Burimet po ashtu tregojnë se një prej tyre është shoqëruar në policinë e Shkodrës dhe është marrë në pyetje goftë nëse kanë parë autorin por edhe arsyet pse ndodheshin aty në atë moment. Personi që udhëhiqte grupin e turistëve ka sqaruar se nuk kanë parë asgjë dhe se aty kanë qenë thjeshtë për qejf duke lundruar në liqen dhe duke bërë hipizëm me kuaj si pjesë e guidës së tyre turistike. Prania e turistëve në afërsi të vendit ku u vra Arian Ferracaku dhe marrja në pyetje sekret nga forcat e policisë, por burimet kanë treguar në lidhje me praninë e tyre aty.

SHKODER - Pas ekzekutimit të biznesmenit Arian Ferracaku në Shkodër disa ditë më parë, të tjera detaje dalin në dritë. Burime pranë prokurorisë së Shkodrës bëjnë me dije se pranë vendit ku ndodhi vrasja në zonën e 'Livadeve' kanë qenë të pranishëm një grup turistësh. Një grup shtetasish nga Kosova kanë lundruar në liqenin e Shkodrës dhe më pas disa prej tyre jo shumë larg nga vendi ku ndodhi vrasja kanë bërë hipizëm me kuaj duke qenë se ishte pjesë e guidës turistike që kishin zgjedhur. Sipas burimeve turistët nuk kanë qenë më shumë se afro 500-600 metra larg nga vendi ku mbeti i vrarë shtetasi Ari-

38-vjeçarja muxhahedine: Ëndrra ime është liria e njerëzve të mi

'Akuzat e Mustafa Mohammadi se jam rrëmbyer nga MEK, janë të rreme'

Somayah: Po përballem me torturë psikologjike



Somayah Mohammadi

Ina Allkanjari

Somayah Mohammadi me origjinë iraniane, ish-banuese në Kanada, njëra prej 3.000 muxhahidineve anëtarë të opozitës iraniane që mbërritën në Shqipëri nga kampi Ashraf në Iran, prej disa kohësh ka tërhequr vëmendjen e mediaeve. Kjo pas përplasjes të shumta mediatiqe mes 38-vjeçares dhe babait të saj Mostafa Mohammadi, i cili ka deklaruar se muxhahedinët, MEK, të cilët janë strehuar në Shqipëri, e kanë grabitur vajzën e tij dhe nuk e lejojnë ta takojë atë. Nga ana tjetër, Somayah akuzon babain e saj se ai është agjent i të ashtuquajtur regjimit iranien dhe se ai ka ardhur që ta largojë atë nga Shqipëria pa vullnetin e saj edhe pse është në moshë të rritur. Për të bërë sa më transparent faktin se e reja nuk mbahet kundra dëshirës së saj nga MEK, Somayah doli ditën e djeshme në një konferencë për mediat. Ajo deklaroi se ka ardhur në Shqipëri me mbështetjen ndërkombëtare dhe me aksion nga Shtetet e Bashkuara, Kombet e Bashkuara dhe qeveria shqiptare, por babai i saj nuk e lë të qetë. "Unë jam Somayah Mohammadi, anëtare e MEK. Unë me miqtë e mi erdhëm në Shqipëri me mbështetjen ndërkombëtare dhe me aksion nga Shtetet e Bashkuara, Kombet e Bashkuara dhe qeveria shqiptare. Që kur kemi ardhur në Shqipëri, jo vetëm që nuk kemi pasur asnjë problem me popullin shqiptar, por ky popull është treguar gjithashtu, shumë përkrahës e miqpritës ndaj nesh. Por një agjent famëkeq i Ministrisë së Inteljencës së regjimit iranien, me emrin Mostafa Mohammadi, ka ardhur në Shqipëri që para dy muajsh, afërsisht. Fatkeqësisht, ai është babai im. Ai

pretendon se jam rrëmbyer nga MEK 21 vite më parë dhe tani jam e burgosur në Manzë, dhe se qeveria shqiptare po bashkëpunon me MEK për sa i përket burgosjes sime. Gjatë kësaj periudhe, unë u kam dërguar letra ministrit të Brendshëm shqiptar dhe mediaeve në lidhje me akuzat e tij të rreme. Kam pasur, gjithashtu, disa intervista ku kam shpjeguar qëllimin e regjimit iranien për dërgimin e këtij agjenti të njohur në Shqipëri. Edhe sot jam e lumtur që ju, gazetari i medias shqiptare, jeni këtu dhe mund t'ju shpjegoj këto gjëra në mënyrë të drejtëpërdrejtë", deklaroi Somayah Mohammadi. 38-vjeçarja akuzon babain e saj për dhunë psikologjike ndaj anëtarëve të MEK. Ajo shprehet se Mostafa Moham-

madi punonte për Ministrinë e Inteljencës së regjimit iranien kundër MEK. "Në vitin 2004, kur ishim në Irak, kuptova se im atë po punonte për Ministrinë e Inteljencës së regjimit iranien kundër MEK. Kështu që i ndërpava të gjitha komunikimet me të dhe thashë se nuk do të isha e gatshme të takohesha më me të. Në Teheran, ai mori viza për të shkuar në Irak. Për dy vjet, ditë e natë, ai rrinte jashtë kampit Ashraf për të bërë torturë psikologjike kundër anëtarëve të MEK përmes 320 altoparantëve. Na kërcënonte me vrasje e djegie. Në të njëjtën kohë, gjykata iranëse e refuzoi akuzimin e tij se MEK më kishte rrëmbyer. Unë jam taktuar personalisht me autoritetet amerikane, me Kryqin e Kuq dhe me

AKUZA
"Babai im pretendon se jam rrëmbyer nga MEK 21 vite më parë dhe tani jam e burgosur në Manzë, dhe se qeveria shqiptare po bashkëpunon me MEK për sa i përket burgosjes sime. Gjatë kësaj periudhe, unë u kam dërguar letra ministrit të Brendshëm shqiptar dhe mediaeve në lidhje me akuzat e tij të rreme",- u shpreh Somayah Mohammadi.

UNHCR, si dhe me autoritetet irakene shumë herë. Gjithashtu, kam bërë kallëzim personalisht në policinë e Manzës dhe Durrësit, dhe kam kërkuar që Mostafa Mohammadi të përjashtohet nga Shqipëria. Prokurori i Durrësit ka konfirmuar që unë qëndrojmë me MEK me vullnetin tim. Siç e shihni, unë jam në këtë vend të lirë, në Shqipëri, pa asnjë kufizim. Mund të shkoj në Tiranë e Durrës për të blerë, për t'u vizituar tek mjeku, apo për gjëra të tjera, sa herë të dua", u shpreh 38-vjeçarja. Më tej Somayah theksoi se prania e Mostafait babait të saj në Shqipëri sipas saj është një fushatë denigruese nga Ministria e Inteljencës së regjimit iranien dhe ambasada iraniane në Tiranë kundër MEK-

ut për të zhvilluar një operacion terrorist në Shqipëri. "Por, le të flasim se cila është çështja kryesore, dhe se për çfarë qëllimi bëhet kjo fushatë denigruese kundër MEK. Që nga fillimi i këtij viti, regjimi iranien është përballur me një kryengritje mbarëkombëtare që kërkon përmbymbjen e tij. Kjo kryengritje është drejtuar nga forcat e MEK brenda Iranit. Për këtë arsye, regjimi iranien kërkon të godasë MEK-un dhe të realizojë operacione terroriste kundër kësaj organizate në mënyrë që ta ndalojë kryengritjen dhe ta vonojë përmbymbjen e tij. Kështu pra, thënë shkurt, prania e Mostafa Mohammadi-t në Shqipëri dhe pretendimet e tij kundër meje dhe MEK nuk janë gjë tjetër veçse një fushatë denigruese nga Ministria e Inteljencës së regjimit iranien dhe ambasada iraniane në Tiranë kundër MEK-ut për të zhvilluar një operacion terrorist në Shqipëri. Për këtë arsye, në letërën time drejtuar ministrit të Brendshëm, kam kërkuar përjashtimin e Mostafa Mohammadi-t nga Shqipëria", deklaroi Somayah Mohammadi. 38-vjeçarja shprehet se e vetmja gjë që dëshiron, ëndrra e saj është liria e iranianeve. "Ëndrra ime është liria e iranianeve, liria e njerëzve të mi", - tha 38-vjeçarja.

SHKURT

Vidhet gjatë natës Katedralja në Korçë

KORÇE - Grabitet në Korçë katedralja në qendër të qytetit. Persona të paidentifikuar kanë thyer, gjatë mbrëmjes së djeshme derën e Katedrales dhe kanë dëmtuar ambientet e brendshme të saj. Pasi kanë marrë paratë e arkës, hajdutët janë larguar menjëherë në drejtim të paditur. Në një prononcim për mediat, At Ilia Kotnami u shpreh se kjo nuk është hera e parë që ndodh. Kishat dhe objektet e kultit kanë qenë pre e grabitësve edhe më parë. At Kotnami shtoi se hajdutët kanë qëndruar në kishë gjatë mesditës, dhe në përfundim të saj kanë vjedhur paratë që ndodheshin në arkë. Sipas tij, autorët kanë mundur të marrin nga arka rreth 200 mijë lekë (të vjetër).

Bëjnë për spital vëllain, arrestohen babë e bir në Dibër

DIBER - Policia e Dibrës ka arrestuar babë dhe bir, pasi kanë ushtruar dhunë ndaj vëllait të tij për motive pronësie. Në pranga ka përfunduar Elidon Cena, 25 vjeç, banues në fshatin Ushтеленxë, Dibër (babë e bir). Sipas policisë, arrestimi i tyre u bë pasi, në fshatin Ushтеленxë, shtetasi Xhevdet Cena në bashkëpunim me djalin e tij Elidon Cena për motive pronësie kanë ushtruar dhunë fizike ndaj vëllait të tij, shtetasit A.C. 43 vjeç. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për veprën penale "Dhunë në familje", kryer në bashkëpunim.

Grabiti marketin me pistoletë lodër, kapet 27-vjeçari

DURRËS - Ndërhyrja në kohë e policisë së Durrësit kap në flagrancë autorin e vjedhjes me dhunë të një marketi nën kërcënimin e një pistolette lodër. Sekuestrohet pistoleta çakmak, sasia e parave të vjedhura, një maskë kirurgjike dhe doreza. Në pranga ka rënë Keni Braçe 27 vjeç, banues në Durrës. "Braçe, në lagjen Nr.8 Durrës ka vjedhur me dhunë nën kërcënimin e një pistolette tip çakmak marketin në pronësi të shtetasit S.M. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprën penale "Vjedhja me dhunë", thuhet në njoftimin policies.

Njoftim për shitje me ankad

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezuesin K.S. Në ndodhur në fshatin Pançorë. Pasuria që shitet në ankad përbehet nga:

"Pasuria A" me nr. 206/48 vol. 5 fq.31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869 me cmin 1.200.000 lekë

"Pasuria B" me nr. 206/7 vol. 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmin prej 80.000 lekë

"Pasuria C" me nr. 70/15, vol.6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me cmin në masën 400.665 lekë

Ankandi është progresivë e do të zhvillohet dt 13.09.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishit" Kulla 1, Kati 2, zyra.5. Kont tel. 672082543, e-mailit: llir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 02.10.2018 8 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paluajtshme. Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie 690, volumni 9, faqe 174, zona kadastrale 1979 e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare në ankad 25.200 (Njëzet e pesë mijë e dyqind) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 01.10.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtëse me sipërfaqe 126 m²; regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankad 81,043 (Tëthëdjete e një mijë e dyzet e tre) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Personat e vënë në pranga janë të grupmohave 15 deri 20 vjeç. Ja si vepronin trafikantët

Vidhnin mjete lundruese në Greqi e Shqipëri, arrestohen 4 të rinj

Gomonet do përdoren për trafik droge

Arbër Sulo

SARANDË

Katër të rinj janë arrestuar në kuadër të një operacioni të përbashkët të policisë greke dhe shqiptare të koduar "Butrinti". Personat e vënë në pranga janë të grupmohave 15 deri 20 vjeç dhe akuzohen për vjedhje të mjeteve lundruese në Sarandë dhe në Korfuz.

Operacioni është drejtuar nga drejtues të Komisarariatit të Policisë Sarandë, të cilët kanë pasur dhe informacionin e parë për këtë çështje. Më tej është informuar dhe është kërkuar bashkëpunimi i Komisarariatit të Policisë Kufitare dhe Policisë greke të Korfuzit. Konkretisht në prangat e policisë kanë rënë FLleshaj, 17 vjeç, lindur në Mirditë dhe banues në fshatin Shëndëlli, Sarandë; A.Dedaj, 15 vjeç, lindur në Mirditë dhe banues në fshatin Shëndëlli; Kristi Dedaj, 20 vjeç banues në Shëndëlli dhe L. Prenga, 17 vjeç banues në Shëndëlli.

Dy ditë më parë në grykëderdhjen e lumit "Pavillo", u bë e mundur bllokimi i një mjete lundrues tip "Gomone" me mbishkrimin "Highfield", në të cilin u arrestuan në flagrancë FLleshaj dhe A.Dedaj. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit A.Dedaj, u gjet dhe u sekuestrua një mjet lundrues varkë plastike me mbishkrimin "Evinrude", pa dokumentacion. Gjithashtu, si rezultat i bashkëpunimit nga ana e policisë greke, është bërë i mundur arrestimi i dy shtetasve të tjerë në ishullin e Korfuzit Greqi, të cilët janë kapur në flagrancë duke vjedhur mjete lundruese (skafe). Policia e Korfuzit në deklaratën e saj për shtyp jep detaje duke thënë se dy shqiptarët 17 dhe 20 vjeç janë kapur në zonën detare të quajtur Gouvia duke drejtuar një gomone, e cila tërhiqte një tjetër, të cilat ishin vjedhur nga dy veliera dhe shërbënin si mjete ndihmëse të velierave. Ata do të procedohen nga policia greke edhe për kalim të paligjshëm të kufirit. "Finalizohet operacioni i përbashkët midis policisë së Sarandës, Policisë Kufitare dhe asaj greke, i koduar "BUTRINTI", sekuestrohen 5 mjete lundruese (2 nga pala jone, 3 nga pala greke). Arrestohen në flagrancë 4 persona (2 nga pala shqiptare, 2 nga pala greke). Policia e Sarandës



Gonomia e sekuestruar

në bashkëpunim me Policinë Kufitare Sarandë dhe policinë greke, kanë siguruar informacion në rrugë operative për persona që vjedhin mjete lundruese nga fshati Shëndëlli, Sarandë", thuhet në njoftimin e policisë së shtetit. Bëhet me dije se nga ana e policisë shqiptare janë bllokuar dhe sekuestruar 2 mjete lundruese gomone

"Highfield", motor "Mërkuri" me 9HP. Varkë plastike "Evinrude" 25HP Ndërsa policia greke ka sekuestruar 3 mjete të tjera lundruese në Ishullin e Korfuzit, Greqi. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se të rinjtë shkonin në Korfuz me varkë, linin varkën aty dhe vidhnin gomonen që e sillnin në Sarandë. Indicia për

hetimin erdhi pas vjedhjes në Sarandë të varkës që përdorin trafikantët për të shkuar në Korfuz. Ndërkohë mësohet se mjetet që vidheshin do përdoren për trafik droge. Materialet procedurale në ngarkim të shtetasve FLL., dhe A.D., iu referuan Prokurorisë për veprat penale "Trafikimi i mjeteve motorike" dhe "Vjedhje".

Llesh Buraku një emër i njohur për policinë

Tritol lokalit në Laç, pronari i tij kërcënon me armë gazetarin e News24

LAÇ-Një sasi tritol ka shpërthyer mëngjesin e djeshëm në hyrje të një lokali në lagjen Nr.4 të qytetit të Laçit. Fatmirësisht nga shpërthimi nuk raportohet për persona të lënduar, por vetëm dëme materiale.

Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:00 në lokalit në pronësi të Llesh Buraku, ndërka nuk dihen ende shkaqet dhe motivet. "Më datë 03.09.2018, rreth orës 02:00, në lagjen Nr.4 në Laç, në derën e jashtme të lokalit "Bar-Kafe" në pronësi të shtetasit Ll.B. ka shpërthyer një sasi lëndë eksplozive, ku si pasojë ka vetëm dëme materiale. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorit. Materialet procedurale u referuan



Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për veprën penale "Shkatërrim prone me eksploziv" thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, pas ngjarjes një episod u shënuar mes gazetarit të News24, Prend Shota dhe pronarit të lokalit, pasi ky fundit nuk e ka lejuar atë të filmojë pasojat e sulmit në lokal. Madje gazetari Shota është kërcënuar me armë të mos qëndrojnë në ambientet e lokalit. Llesh Buraku, pronari i lokalit, nuk është

emër i panjohur për policinë. Në korrik të vitit 2015, ai kishte dhunuar duke e goditur me grushtet inspektorin e Shëndetit Publik, i cili kishte shkuar për kontroll në lokalit e 54-vjeçarit. Ky i fundit kundërshtonte me forcë dhe goditi inspektorin. Për këtë ngjarje, më 28 tetor 2015 Gjykata e Kurbinut i shpalli fajtor Llesh Buraku për veprën "goditje për shkak të detyrës" dhe e dënoi me 150 mijë Lekë gjobë.



Në vend të tij emërohet Stefan Çipa

Shkarkohet nga detyra Drejtori i Burgjeve Arben Çuko, motivi: Kritja e sigurisë në burgje

TIRANË- Ministria e Drejtësisë Etilda Gjonaj ka shkarkuar nga detyra Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve Arben Çuko. Në vend të tij është emëruar Stefan Çipa, ish-kryebashkiaku i Sarandës dhe zëvendës ministër i Brendshëm. Motivacioni i këtij ndryshimi është rritja e sigurisë në burgje. "Largohet nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, z.Arben Çuko dhe në vend të tij emërohet z.Stefan Çipa. Ky ndryshim bëhet për të përmirësuar punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, veçanërisht në drejtim të rritjes së sigurisë së brendshme dhe kontrollit si dhe rritjes së efikasitetit të luftës kundër korrupsionit në sistemin e burgjeve", thuhet në njoftimin zyrtar të shpërndarë nga Ministria e Drejtësisë. Arben Çuko nga deputet i PS mori detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në korrik të vitit të kaluar dhe zëvendësoi Arjan Hoxhën, i cili u emërua në këtë post pas marrëveshjes Rama-Basha. Çuko ka qenë anëtar i Komisionit të Sigurisë, Komandant i Gardës së Republikës dhe këshilltar i kryeministrit të Kosovës për Sigurinë. Ndërsa Çipa vjen nga detyra e zv/ministrit të Brendshëm. Aktualisht është dhe sekretar për emigracionin në PS. Në zgjedhjet e vitit 1997, Çipa u zgjodh deputet i Kuvendit të Shqipërisë për herë të parë, e më pas edhe në 2 legjislatura të tjera. Gjatë legjislaturës 1997-2002, ka mbajtur funksionin e zv/kryetarit të Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare. Në muajin shkurt 2002, emërohet ministër i Rendit Publik, detyrë që e ushtroi deri në muajin gusht 2002. Në zgjedhjet lokale të vitit 2011, z. Çipa u zgjodh kryetar i Bashkisë së Sarandës, për një mandat 4-vjeçar. Në datë 13 janar 2016, u emërua nga Këshilli i Ministrave, zëvendësministër i Punëve të Brendshme.

Plumbat ndaj banesës së prindërve të Klodiana Lalës, gazetari italian: Sulme burracakësh



TIRANË-Gazetari investigativ italian Luigi Pelazza ka folur për News24 për sulmet ndaj gazetareve. Ai ka shprehur solidaritet me gazetaren Klodiana Lala, pas sulmit që familja e saj përjetoi ditët e fundit. "Si fillim dua t'i dërgoj solidaritetin tim personal Klodianës dhe gazetareve që kanë pësuar këto sulme burracakësh këto ditë. Edhe në Itali ka raste të tilla me gazetarë që bëjnë punën e tyre në mënyrë të ndershme. Këta gazetarë shoqërohen me eskorta vetëm se kërkojnë të bëjnë ndershmërisht punën e tyre duke treguar trafiqet, mafien, kamorren", tha gazetari italian. Luigi Pelazza, gazetari investigativ i emisionit "Le Iene" në Rai Uno tha se qeveria në Shqipëri duhet të bëjë një hap për të mbrojtur gazetarët. "Unë uroj që kolegët gazetarë në Shqipëri të mos kenë vetëm mesazhe solidariteti, por edhe një hap të qeverisë që të ketë në mbrojtje këdo që ka si profesion gazetarinë dhe këdo që kërkon për të shpërndarë lajmin në mënyrë të ndershme", tha Pelazza.

SPECIALE

DËNIMI I KADRI HAZBIUT, FEÇOR SHEHUT...

Ekskluzive / Dokumenti tepër sekret i sekretarit të parë të Korçës, Enver Halili, për Komitetin Qendror

Raporti: "Feçori dha urdhër për tërheqje të forcave që ndiqnin bandën e Zenel Kelollit"

Dokumenti: "Mihallaq Ziçishti ndërhyri për Thanas Andonin nga Ziçishti që të mos futej në burg"

Nga DASHNOR KALOÇI

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohej "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet Shehu", të cilat do t'i shërbenin më pas Enverit për të shkruar "Tablonë sinoptike për poli gjentimin Mehmet Shehu"! Në të gjitha këto mbledhje, veç të tjerash, ashtu siç bëhet e ditur edhe nga një mori dokumentesh me siglën "Tepër sekret", që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëmarrës e diskutantë të shumtë që kanë marrë fjalën aty, kanë hedhur lloj-lloj akuzash, me të vërteta dhe të pavërteta, denoncime, spiunime, shpifje, trillime, thashetheme, intriga, sajesa e gjithfarë u kanë ardhur për shtat, të gjitha këto në drejtim dhe kundër ish-kryeministrit të vdekur, Mehmet Shehu, familjes së tij dhe atyre që u konsideruan bashkëpunëtorë të tyre, duke përmendur me dhjetëra emra, ushtarakë, funksionarë të lartë, etj. etj. Po kështu, këto mbledhje u intensifikuan së tepërmi, sidomos pas tetorit të vitit 1982, kur u arrestua dhe



Feçor Shehu në gjyq

ministrin i Mbrojtjes Kadri Hazbiu, (i cili për gati tri dekada me radhë kishte mbajtur postin delikat të ministrit të Brendshëm), ku dhe ndaj tij, u përsërit e njëjta tablo, si me ish-kryeministrin Mehmet Shehu. Dhe pas zhvillimit të këtyre mbledhjeve, komitetet e partisë të rretheve përkatëse, kanë hartuar një sërë raportesh me përmbledhje nga "problemet më kryesore", të cilat më pas ia kanë dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së. Për të gjitha këto mbledhje, "Gazeta Shqiptare" disponon një numër të madh dokumentesh të nxjerra nga një dosje voluminoze me siglën "Tepër sekret", ku ish-anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të Komitetit Qendror të asaj kohe, si Spiro Koleka, Enver Halili, Vangjel Çerrava etj, etj, informojnë Komitetin Qendror për mbledhjet ku kanë marrë pjesë, duke dhënë me detaje dhe hollësiira gjithçka është thënë dhe diskutuar aty. Po kështu përveç këtyre raporteve,

në dosjen në fjalë, gjenden edhe një sërë raportesh të hartuara nga funksionarë të rangjeve më të ulta që nga Komiteti Qendror e më poshtë, apo dhe raportet kolegjiale të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe, shtabeve, komandave dhe komiteteve të partisë së Korpuseve ushtarake, që ishin edhe njësitë më të mëdha që kishte Ushtria shqiptare asokohe. Nga kjo dosje voluminoze që "Gazeta Shqiptare" e disponon të plotë, në dy numrat e kaluar

(vijon nga numri i kaluar)

PARTIA E PUNES E SHQIPERISE
KOMITETI I PARTISE RRETHIT
Korçë
më 23.10.1982


INFORMACION

Për DISA PROBLEME QE DUALLEN NGA DISKUTIMI I KONKULZIONEVE TE BYROSE POLITIKE DHE TE PLENIUMIT TE 5-TË TE KQ TE PARTISE NE ORGANIZATAT

BAZE TE PARTISE TE DEGES SE PUNEVE TE BRENDESHME DHE TE PROKURORI-GJYKATES

Këto kanë çuar deri aty sa ndonjë kuadër i Sigurimit të bëjë skandal, të nxjerrë pistoletën në vëndë publike. Të futen edhe në fushën e sportit një "buj-omani", që linte të kuptohej se po vjen Dega, ajo të bën këtë dhe atë, gjë që kishte krijuar disa herë një ndrojje dhe frikë në popull.

Shfaqjet e kapadaillekut e të mungesës së thjeshtësisë si punëtorë Partie vihen re tek disa kuadro të Sigurimit që nga drejtues e deri tek punëtorët operativ. Ndonjë prej tyre për të mbuluar të metat e punës e për të bërë atë të pakontrollueshme nga Partia dhe organet e pushtetit, ka spekuluar në punën e mbyllur, e cila në disa raste është fëtitshuzuar. Kulti është reflektuar gjithashtu edhe kur ndonjëri mundohet ta trajtojë Hetuesinë si lloj të punës agjenturore-operative, apo në rastet kur kuadrot e Sigurimit shprehen që: "Për çdo gjë që kërkohet në zonë duhet pyetur punëtori operativ, pasi ai është zot i vëndit". Ky koncept është mbështetur dhe inkurajuar edhe nga Ministria. Bujomania në kryerjen e detyrave, përdorimi në disa raste dhe nga disa punonjësit me dhe pa vënd i veturave të ndërmarreve e institucioneve për punë zyrtare e personale, ka çuar në mëndimin se këta kanë punë shumë të rëndësishme. Në ndonjë rast kulti i punonjësit të Degës është ushqyer edhe nga element të të lëkundshëm të cilët në rrugë të ndryshme i kanë afruar ata dhe duke i mburrur nëpërmjet dhënies së



Kadri Hazbiu me një grup oficerësh

dhuratave, etj.

Ka pasur raste që nga ana e punonjëseve të Degës së Punëve të Brendshme janë bërë kontrollë për ruajtjen e sekretit në rreth e në bazë, në organet e pushtetit dhe të ekonomisë. Kjo ka kultivuar mendimin tek ndonjë se Dega e Brendshme është gjithçka, bile dhe mbi organet e pushtetit.

Veprimet të arrogancës e prepotencës janë bërë edhe nga kuadro të policisë, duke shkelur ligjet dhe rregullat siç është rasti i sjelljes brutale me punonjës të kuadro në stadium, ose rasti i dy kuadrove që marrin me forcë rojen e Ndërmarrjes së Përpunimit Drurit dhe e çojnë në polici, duke lënë për një kohë dhe objektin pa roje. Kulti ka çuar ndonjë, siç është rasti i punëtorit operativ, që i kërkon sekretarit të organizatës-bazë të një institucioni ku i punon të godasin dhe ushtarët, gjë të studjohet protokollin e mbledhjes së organizatës, se kush dhe përse e kishin kritikuar gruan e tij, gjë e cila u kritikua rreptë nga Komiteti i Partisë i rrethit.

Në ndonjë rast sjellje arrogante janë bërë edhe nga disa oficerë të kufirit në marrëdhëniet me popullin dhe ushtarët, duke arritur deri aty si në postën e Vidohovës e Kallamasit që të godasin dhe ushtarët, gjë për të cilën u muarrën masa të rrepta. Kritika për shfaqjet të arrogancës janë bërë edhe për kuadro kryesorë të Degës. Në organizatën e Policisë u bënë mjaft kritika për shefin e Policisë së Rrethit, Hajredin Shty, i cili sillte me arrogancë, nuk përfilloi sa dhe si duhet mendimet dhe propozimet e komunistëve, nuk i çon deri në fund propozimet



për punonjësit të veçantë të Policisë që kanë nñjolltur figurën morale, etj.

heshin. Pikërisht këtë qëllim kishte dhe armiku Feçor Shehu, kur thoshte se: "Ç'u bë Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkimet Profesionale". Veprimtaria armiqësore e këtij grupi ka

synuar që në metodën e punës në marrëdhëniet me njerzit të mbisundonte arroganca e prepotenca e shfrenuar, mbytia dhe ndrydhja e kritikës për t'i bërë njerzit të frikshëm ndaj pushtetit të tyre.

3. Edhe në politikën e trajtimit, emërimit dhe lëvizjen e kuadrove janë bërë gabime.

Në të gjitha organizatat-bazë të Partisë kemi komunistë që kritikau veprimet e qëndrimet armiqësore të Kadri Hazbiut e Feçor Shehut ndaj politikës së Partisë me kuadrin. U shpreh mendimi që të shihet me kujdes efektiviteti i Ministrisë së Punëve të Brendshme ku ka pasur familjaritet të sëmurë, mungesë kritike dhe humbje të frymës revolucionare pasi janë grumbulluar edhe disa njerëz me vese të këqija si karrieristë, servilë, dembelë, imoralë, thashethemexhinj, pjanecë, arrogantë e prepotentë. Të shihet gjithashtu se ka shumë kuadro nga Vlorë dhe Tepelena, ndonjë edhe me lidhje farefisnore e krushqi me të grupit armiqësor. Disa nga njerzit që janë marrë atje qoftë edhe në vënd të rëndësishme megjithëse të paaftë, janë marrë mbi baza njohje dhe simpatit personale duke i nxjerrë me shërbie edhe jashtë shtetit.

Duke pasur parasysh



ndikimin e kësaj veprimtarie, u kritikuan qëndrimet konformiste të shokëve që janë marrë me problematikën e kuadrit si p.sh. zv/ministri përkatës, drejtorët e Kuadrit, Petro Zisi dhe Ilo Manushi, për faktin se kanë lejuar qëndrime të tilla për një politikë krahinore. U kritikua veprimi i Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, Hajro Malile, që ka ndikuar në marrjen e mjaft kuadrove nga rrethi i tij, Gjirokastra. Vërejtje u bënë njëkohësisht edhe për qarkullimin që duhet t'u bëhet kuadrove në Ministri dhe jo siç është vepruar duke i qarkulluar brenda për brenda Tiranës, pa shkuar në rrethe.

Një politikë e tillë është bërë edhe për Degën e Punëve të Brendshme Korçë, ku janë dërguar mjaft oficerë nga Vlorë, 4 prej të cilëve janë nga i njëjti fshat i Vlorës dhe dy të tjerë po nga Vlorë janë baxhanakë. Kjo ka bërë që të vihet re njëfarë familjariteti që e dëmton punën.

Kritika u bënë edhe për mënyrën e ndarjes së degëve në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga komisioni përkatës ku fëmijët e disa kuadrove me përgjegjësi janë lejuar të shkojnë në degën e Sigurimit pa marrë parasysh cilësitë e dobta të tyre morale, gjë e cila ka pasur ndikim e veta në kohën kur ata kanë dalë në jetë, ndërsa në atë të Kufirit, e të Policisë, janë caktuar përgjithësisht.

4. Eshhtë mënjauar deri diku Sigurimi i Udhëheqjes së Partisë duke u mbështetur më shumë në komanda dhe armët e saj.

Këta armiq, edhe për Sigurimin e udhëheqjes së Partisë kanë pasur synime të këqija. Kjo është shprehur edhe kur kanë ardhur e kanë punuar në Degë, shumë pak ata takoheshin me sekretar-in e Komitetit, ose aspak me sekretarët e organizatave bazë, pra linin të kuptojë që është komanda ajo që zgjidh problem, etj. Kjo bën që të spothejë rolin udhëheqës i Partisë, e cila shumë pak ka reflektuar dhe në veprimtarinë konkrete të komunistëve. Kjo pasqyrohet në atë që komunisti apo kuadri për-gatitet më seriozisht për të raportuar para shefit ose në

komandë, por nuk ka atë preokupacion dhe nuk ndëj-n atë përgjegjësi kur raporton në organizatën bazë të partisë.

Mjaft komunistë në organizatën bazë të Partisë nxuarrën përgjegjësitë e tyre që mjaft çështje i shinin që ishin në kundërshtim me vijën e Partisë, por këto problem nuk i kanë ngritur në Parti, qoftë në organizat-tat bazë apo në organe më të larta të Partisë. Eshhtë fakt, u tha-që nuk kemi bërë asnjë relacion me iniciativë për të informuar Partinë për shkeljen e ligjeve e të metave në punën e seksioneve dhe kuadrove të Degës së Punëve të Brendshme. Por edhe seksionet e veçanta të Degës pak kanë qenë të predispoz-uara për të ngritur proble-me para Partisë, për të ndi-hmuar dhe kërkuar sigu-rimin e udhëheqjes së saj, kjo edhe për faktin se disa nga këto problem janë fu-ture në kornizat e një pune të mbyllur. Këto të meta kanë ardhur edhe se jo dhe sa duhet komunistët kanë punuar për të ngritur nive-lin e tyre ideu-politik, pak u është kërkuar në këtë drejtim nga organizatat bazë e Komiteti i Partisë, një gjë e tillë ka bërë që të mos jenë në gjëndje sa duhet për të kapur e vlersuar drejt situ-atat si dhe veprimet e kë-tyre agjentëve.

DISA NGA PROBLEMET E VEÇANTA NE DEGEN E PUNEVE TE BRENDESHME

Në rregulloret ushtar-ake të Kufirit, nuk ka thënie të shokut Enver Hoxha, por thënie të Mehmet Shehut dhe Kadri Hazbiut, bile të nënvizuara.

Feçor Shehu ka dhënë urdhër për tërheqje të forcave që ndiqnin bandën e Zenel Kelollit.

Janë bërë shkelje në kufi me gjueti nga Mihallaq Zicishti dhe ish-komandan-ti i Kufirit, Fasli Shahinasi dhe kanë gjuajtur me armë zjarri.

Kuadrot e Ministrisë kur venë për kontroll me tëpër i kushtojnë rëndësi dokumentacionit, se sa veprimtarisë konkrete me njerzit.

Kërkesat për detyrat që ndjek Policia kanë qenë më të forta nga Ministria se sa kërkesat për Sigurimin për zbulimin e spiunëve.

-Organikat e Policisë shkurtoheshin, mbrojtja e pronës nga Sigurimi i u kalua Policisë, organikat mbetën të pandryshuara.

-Të shikohen disa akte normative të Policisë se ka prej tyre që kanë ndikuar për veprimtari të rregullta, ka edhe akte që vijonë në kundërshtim me njera tjetrën. Ministria ka ndryshuar shumë akte normative për të vënë në korniza punën e bazës.

-Mihallaq Zicishti ndërhyri për Thanas Andonin nga Zicishti që të mos futej në burg dhe në gjyq, Kiço Treska e nxorri të pafajshëm.

-Në Drejtorinë e Dytë të Sigurimit të Udhëheqjes është i quajtur Bashkim Musai, i cili ishte me grupin e shoqërim të Mehmet Shehut dhe i kishte shkuar jo njëherë në shtëpi me peshqeshe. Ka shoqëruar Mehmet Shehun në Francë. Si njeri i besuar i tij ka sjellë në Tiranë njerzit e tij motër e vëlla, etj. Për Fiqërete Shehun ishte njeriu më i besuar, i cili e shoqëronte kudo. U transferua në Drejtorinë e Dytë të Sigurimit të Udhëheqjes para vetëvrasjes së Mehmet Shehut.

-Mustafa Bakiasi, ish-sekretetari i Byrosë në Drejtorinë e Dytë, u mjaftuan me shkarkimin si sekretar dhe u emërua kryetar dege po në drejtori, bile ju shuia dhe rrogja. Eshhtë njeri pa respekt në masë, i njohur si servil i Llambi Pëçinit, Bato Karafilit dhe Feçor Shehut.

-Kritikohet Inspektoriati Rrugor që jep shumë dënime për shoferët, aq sa komisioni quhet "gjyq".

-U bënë vërejtje për disa oficerë që sigurojnë udhëheqjen që janë të pasjellshtëm dhe preren pas rraqeve dhe të ngrënave.

-Për Kadri Hazbiun:


Kur nga një punëtor operativ është ngritur problem se armiku Haxhi Hajdari shkonte tek një i riad-hesuar politik në kohën kur ishte akoma pa u demaskuar si armik, e ka ndëshkuar këtë punëtor operativ duke i thënë se; kush ta jep ty të drejtën se çfarë bën Haxhi Hajdari?! Gjith-ashtu kur po jep punëtor operativ, ka ngritur proble-min se Mihallaq Zicishti është shpëruar në kufi me një mjek që më vonë u arrat-is, kjo u mbyll prej tij.

Duke qenë nënkryetar i Komisionit të Internim Dëbimeve ka lejuar që në vënd të tij të firmosi Feçor Shehu.

Ka zbatuar politikë personale për kuadrin duke sjellë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të afërmit dhe miqtë e tij e njerëz nga krahina.

SEKRETARI I PARE I KOMITETIT PARTISE SE RRETHIT

ENVER HALILI (vijon)



Manastirliu: Transparençë me barnat e rimbursueshme

Receta elektronike edhe në QSUT, lehtësohen pacientët

Receta me rimbursim online tashmë do të jetë edhe në dispozicion të QSUT. Rreth 90 mjekë të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë kanë nisur të përkrahajnë recetën elektronike përmes sistemit të e-recetës, duke pasur mundësi të shohin në sistem edhe historikun e trajtimit të pacientit. Pa-

cientët do të kenë më pak procedura burokratike për recetën me rimbursim si dhe do të kenë më shumë siguri sa i takon trajtimit të tyre, pasi përmes evidencimit online të pacientit, me recetën elektronike eliminohet mundësia e gabimit njerëzor në përshkrimin e barnave me rimbursim. Sipas ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta

Manastirliu, shtrirja e recetës elektronike në QSUT është një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të transparencës dhe kontrollit të barnave me rimbursim. Mjekët e QSUT-së i bashkohen 1400 mjekëve të rajonit të Tiranës, Kamëz-Vorës, Durrësit, Fierit, Shkodrës, Korçës, Elbasanit, Vlorës, Beratit, Dibërës dhe Lushnjës që tashmë përdorin recetën elektronike. Sistemi i recetës elektronike pritet të shtrihet brenda vitit 2018 edhe në rajonet e Kukësit, Gjirokastrës, Sarandës, Tropojës dhe Lezhës, duke bërë të mundur që brenda vitit 2018 në të gjithë sistemin shëndetësor parësor të përdoret receta elektronike.

Kryebashkiaku Erion Veliaj: Po ndërtojmë gjimnaze, do zhdukim turnet e dyta

Punimet për rehabilitimin e shkollës "Ismail Qemali" drejt fundit

"Do ulet ndjeshëm trysnia në shkollat e mesme"

Një prej shkollave ikonë të Tiranës, "Ismail Qemali", do t'i kthehet shkëlqimi i dikurshëm. Bashkia e Tiranës po i jep dorën e fundit punimeve për rikonstruksionin e plotë të klasave, palestërës dhe ambienteve sportive të jashtme, ndërsa ka instaluar edhe sistemin e ngrohjes qendrore. "Jam shumë i lumtur me progresin që kemi bërë për rikonstruksionin e shkollës "Ismail Qemali". Shkolla mban emrin e një prej personazheve më të rëndësishëm të historisë shqiptare, shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Kjo e jona është një përpjekje modeste për të shpallur pavarësinë nga i ftohti, lagështia, rrëmuja, zhurma, nga një shkollë e rrënuar. Por këtë lloj pavarësie të kohëve moderne mund ta bëjmë me punë, jo me fjalë. Ndaj, i gjithë gushti ka qenë një muaj sulmi, po ashtu edhe fillimshatori do të jetë një muaj sulmi, për t'u siguruar që kapim datën e fillimit të shkollës", tha Veliaj. Kryebashkiaku theksoi se me hapjen dhe shtimin e kapaciteteve në disa shkolla të tjera, edhe në këtë shkollë Ismail Qemali është ulur numri i nxënësve nëpër klasa. "Pra, nga një shkollë me 40-50 nxënës në klasë, bëhet një shkollë me 32 nxënës në klasë. Kjo do të thotë se ka më pak nxënës për të njëjtin mësues, rrjedhimisht më shumë vëmendje për secilin nxënës dhe një



shans më të madh që secili nxënës të dalë akoma edhe më mirë në mësime. Por, ky lajm i mirë ka gjasa të tundohej nga një presion konstant që vjen nga prindërit. Këshilla ime për prindërit është kjo: nëse jeni banorë të zonës, të Njësisë 2 që ju prek ky pellgu i "Ismail Qemalit", atëherë kjo është shkolla juaj. Nëse jeni më afër me "Abdulla Ketën" në Shkozë, nëse jeni më afër me "Sandër Prosin" në Sauk, atëherë mënyra më e mirë është për të regjistruar fëmijët atje. Duke i regjistruar nxënësit atje, do të thotë që

do kalojnë më pak kohë në rrugë vajtje-ardhje, më pak varavingo dhe më shumë kohë në librat", u shpreh Veliaj. Veliaj bëri të ditur se shumë shpejt nis ndërtimi i 17 shkollave të reja në kryeqytet, çka jo vetëm do të ulë numrin e nxënësve në klasa, por edhe do t'i japë fund mësimt me dy turne. "Do të fillojmë me 17 shkollat e reja. Një pjesë e tyre janë gjimnaze, të cilat do ta ulin ndjeshëm trysninë, kështu që viti tjetër edhe për gjimnazet e Tiranës do të jetë fundi i gjimnazeve me dy turne", theksoi ai.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA E LLOJIT 'PYLL + KULLOTË', ME SIPERFAQE 190.000 M2, ZONAKADASTRALE 3028, ME ADRESË: PORO VLORË, NE PRONËSI TË Z. FATIUN UKA.
ÇMIMI 1.824.000 EURO . Data e zhvillimit të ankanit do jetë 15.09.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The objective of the programme reads: "The employment situation for employees and self-employed, especially qualified young people, is improved." The programme follows a nation-wide approach. It has four fields of activity: (i) Vocational Education and Training, (ii) MSME Promotion, (iii) Social Initiatives and (iv) Investment Promotion & Policies and Strategies for Employment Promotion.

The component, "Vocational Education and Training" (TVET), aims to enhance the quality of vocational training and employment in order to match the labour market demands. Thus it contributes to the implementation of the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020), focusing on the Strategic Priority A: "foster decent job opportunities through effective labour market policies" and Strategic Priority B: "Offer Quality vocational education and training for youth and adults".

The second area of action, "Promotion of micro, small and medium-sized enterprises" (MSMEs), aims at building MSMEs capacities to generate economic growth with positive effects in employment, with an eye on improving growth conditions that have an impact on employment and the increase of supply and demand for skilled workers. To that end, the programme will cooperate with clusters of micro, small and medium-sized enterprises, as well as with the business representative associations.

The third area of action, "Social participation of youth and minorities", aims to support civil society social initiatives, focusing on the marginalized youth and teenagers.

The fourth area of action, "Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment", aims at enhancing conditions for the implementation of relevant strategies and projects within selected ministries and their subordinate institutions, like, for example, the Business and Investment Development Strategy 2014 – 2020, and the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020). The programme will play an advisory role on the cross-cutting issues of the first and second areas of action, with particular focus on employment-related issues.

ProSEED builds on the integration of three previous projects, „Vocational Education and Training (Jan 2015 – Dec 2016), „Increasing the competitiveness of MSMEs by promoting innovation and entrepreneurship (ProSME, Oct 2014 - December 2016), and „Economic Good Governance for Improving the Investment Climate (Mar 2015 - Feb 2017). While the three forerunning projects covered certain segments in the area of promoting economic growth and employment (from the perspective of labour offer, labour market demand and general conditions) through isolated interventions, the new programme intends to advance the approach applied so far and extend its scope by way of including new approaches aimed at employment promotion. In this context, the activities are complementary and favour a better matching of labour supply and demand match. The programme overall term is three years, starting from January 2017 until December 2019 (three years).

The programme contributes to reducing structural unemployment and underemployment, and to meeting the demands of the private sector with skilled workers. In this way, it tackles a thematic area of particular relevance to Albania and its further social and economic development.

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Junior advisor - SME, Support and Entrepreneurship-Development

A. Responsibilities

The junior advisor "SME-Support and Entrepreneurship-Development":

- Supports the management of programme activities according to programme goals, operational planning and agreements with the partner structure, namely the Ministry of Finance and Economy and subordinate agencies. This implies support to planning, budgeting, implementation and contribution to monitoring of measures as well as provision of advice to partners in close coordination with the leadership of the programme;
- This entails supporting the management of two intervention areas (i) provision of Business Development Services (BDS) to MSME (ii) provision of entrepreneurship trainings and start-up grants to aspiring entrepreneurs. In both cases, the supporting activities are delivered by external institutions/experts but are to be accompanied and coordinated by the in-cumbers;
- Support representation of ProSEED Private Sector Development component within the "start-up-eco-system", fostering exchange of concepts and cooperation between the different stakeholders in that community;
- Contribute to knowledge management, monitoring and PR of ProSEED;
- Support of GIZ tasks as assigned per need.

The junior advisor performs the following tasks:

B. Tasks

1. Coordination and monitoring

The junior advisor "SME-Support and Entrepreneurship-Development":

- Supports program activities according to program goals, operational planning and agreements with the partner structures. This implies contributing to planning & budgeting, implementation and monitoring of measures within and may entail the accompaniment of external experts. The focus is on work with MSME, entrepreneurship trainings and start-up-support;
- Supports the provision of grants to aspiring entrepreneurs and helps to ensure the smooth functioning of the IDEA-Grant-Assessment-Committee (IGAC) and the quantitative and qualitative monitoring of grant disbursement in close cooperation with the Project Implementation Unit (PIU) at the Ministry of Finance and Economy (MoFE);
- Accompanies the provision of services for MSME and entrepreneurship trainings under the CEFÉ-methodology, contributing to both quantitative and qualitative monitoring;
- Contributes to conceptualise the exploitation of synergies between stakeholders in the Albanian Start-up-eco-system and facilitates their exploitation;
- Accompanies the financial and administrative issues regarding the assigned intervention areas in close coordination with the contract manager of the programme;
- Supports planning, preparation and implementation of workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the program's field of activities.

2. Communication and networking

Assists the Head of Private Sector Development Component in establishing and increasing ProSEED visibility among stakeholders for MSME and entrepreneurship-support;

- Actively networks on behalf of GIZ in the relevant community;
 - Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme.
- ##### 3. Knowledge management
- Assists in improving the program's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
 - Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer and linkages' exploitation especially among the ProSEED team;
 - Supports the preparation of appropriate input to the various project/program reports/publications including annual reports; contributes to other reports required by the AV and the GIZ Headquarter

A. Required qualifications, competences and experience:

- Master's degree in Economics, Education, Social Sciences, Business Administration, or other relevant fields
- Work experience with regards to entrepreneurship/MSME and start-up-support
- Minimally 2 years of professional working experience in a similar position related to entrepreneurship, MSME and start-up-support
- Strong record of professional expertise in his/her field
- Excellent command of MS-Office
- Good working knowledge of modern telecommunication systems
- Language skills (must include Albanian & excellent spoken and written English)

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: until 31.12.2019

Please forward your application until **18 th of September 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanian@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETË SHQIPTARE

E martë 4 Shtator 2018



Klajda Gjoshaj marton të motrën, fotot fantastike...



Jeta e djalit nga Tirana në mediat italiane për punën e pakursyer në spital



Ikën papritur Orinda Huta, ja ku do e shohim

BULEVARDI POLITIK



- Blloku apo Lungomare? Krahasimi i veçantë që gjen Rama
- Andis Harasani i shkruan Ronaldos: Pas një viti të rikthehet fati
- Gjijnuri i ankohet vlonjatëve: Nuk po na lini rehat të pushojmë...
- Kate dhe Meghan s'duhet të veshin rroba ngjyrë portokalli...

ENKEL KALLUSHI

Kardiokirurgu shqiptar që po shpëton jetë në Itali

"Kirurgu i zemrës ka një zemër të madhe"

Jeta e djalit nga Tirana në mediat italiane për punën e pakursyer në spital

Enkel Kallushi

Kardiokirurgu shqiptar që po shpëton jetë në Itali

“Kirurgu i zemrës ka një zemër të madhe”

Vetëm pak ditë më parë, ai ka shpëtuar jetën e dy pacientëve të sëmurë nga zemra në Itali. Shqiptari 44 vjeçar nga Tirana quhet Enkel Kallushi e ka përfunduar studimet e larta për mjekësi. Sot ai punon si kardiokirurg në spitalin e Opa-s në Itali, ku po ushtron me profesionalizëm pasionin e tij më të madh. Misioni i tij është i qartë, të shpëtojë jetë e këtë bëri edhe në mes të temperaturave të larta të fundit të gushtit. Një nga gazetatat italiane ka shkruar për mjekun shqiptar duke vlerësuar kontributin e dhënë gjithë këto vite në shërbim të pacientëve. "Gjyshërit e mi shpresonin të bëheshin mjek për të trajtuar familjen dhe njerëzit e mi. Prindërit e mi donin që unë të isha një avokat", thotë kardiokirurgu për gazetën. Ndërkohë kjo e fundit më tej shkruan se Enkel Kallushi mban zemrat e pacientëve në duart e tij dhe mundohet me të gjitha forcat që ti kthejë ato në jetë. Kështu ndodhi edhe të shtunën e kaluar të gushtit kur në periudhën klasike të pushimeve, mjeku shqiptar së bashku me kolegët e tij arriti pas orëve të gjata të shpëtonte jetën e dy pacientëve që ishin në rrezik. "Dhe ai e bëri atë në heshtje pa u ndier si një hero, por duke punuar krah për krah me ekipin në dy ndërhyrje të veçanta. Ai përfundoi në orën 9 të dielën. Për Enkel Kallushin nuk është një sukses i jashtëzakonshëm, por është pjesë e profesionit të tij që jeton me pasion", shkruan gazeta italiane. Ky doktor profesionist do të mbahet mend gjatë në spitalin e Opa-s për ndërhyrjet kirurgjikale dhe kontributin e tij të pacemuar në fushën e mjekësisë. Ndërkohë kanë qënë vetë të afërmit e një prej pacientëve që shprehën falenderimet e përzemërta për mjekun



■ Mirënjohja

Ky doktor profesionist do të mbahet mend gjatë në spitalin e Opa-s për ndërhyrjet kirurgjikale dhe kontributin e tij të pacemuar në fushën e mjekësisë. Ndërkohë kanë qënë vetë të afërmit e një prej pacientëve që shprehën falenderimet e përzemërta për mjekun shqiptar, pasi sipas tyre Enkeli bëri një mrekulli.


shqiptar, pasi sipas tyre Enkeli bëri një mrekulli.

HISTORIA

Sipas gazetës italiane jeta e mjekut shqiptar është një histori e bukur. "Unë kam lindur në Tiranë. Prindërit e mi dhe motra ime dentiste jetojnë atje. Gjyshërit e mi nuk janë më në jetë, por jam i sigurt që më shohin nga lart. Pas studimeve në Shqipëri kisha mundësi të punoja në OPA, një realitet tjetër shëndetësor ku nuk ka individualizëm, por të gjithë punojmë së bashku me një qëllim të vetëm: shëndetin e pacientëve", shprehet Enkel Kallushi. Ndërkaq, e shtuna e javës së fundit të gushtit do të vinte me dy ndërhyrje kirurgjikale rekord, por tejet të domosdoshme nga ana e mjekut shqiptar. "Urgjenca e dytë erdhi në orën 21:30. Ne përfundam të dielën në mëngjes. Çdo gjë ishte e mundur falë ekipit të anestezistëve; ata dhanë ndryshimin. Ne të gjithë kemi punuar së bashku dhe pacientët tanë janë mirë", shprehet Kallushi. Më tej ai modestisht thotë se ky rezultat i mrekullueshëm erdhi falë angazhimit të thellë të të gjithë stafit mjekësor. "Kirurgu i zemrës ka një zemër të madhe si një përfaqim, ai shpëton jetën", mbyllet shkrimi për kardiokirurgun shqiptar Enkel Kallushi nga gazeta italiane.

Ish-ministrja marton motrën, ja dasma madhështore

Ish-ministrja Klajda Gjoshaj para pak ditësh ka përjetuar emocione të mëdha teksa motra e saj i është drejtuar altarit. Dasma është zhvilluar në kalanë e Lëkursit dhe Klajda ka publikuar foto nga momente më të veçanta me dedikime emocionuese. "Unë jam kaq krenare që jam motra jote dhe aq e lumtur që kam qenë pjesë e përrallës suaj! Ti dhe Wybe jeni çifti më i bukur në botë. Ishte me të vërtetë një martesë e zjarrtë",-ka shkruar ajo. Në njërën prej fotove Klajda shfaqet krahas vëllait të dhëndrit, i cili mesa duket nuk është shqiptar. "Motra më e lumtur e nuses dhe vëllai më i lumtur i dhëndrit! Duke ecur poshtë rreshtit dhe gati për disa momente të veçanta të dy njerëzve tanë më të veçantë",-ka shtuar ish-ministrja.



Julka në kopsht me të voglin, "vuajtjet"...

Data 3 shtator, e hëna e parë e këtij muaji ka përkuar me hapjen e kopshteve dhe çerdheve për më të vegjlit. Julka Gramo, moderatorja e njohur ka zgjedhur t'i ndajë me të gjithë emocionet e ditës së parë të kopshtit për të voglin e saj. Me sa duket gjërat nuk kanë shkuar edhe aq mirë, pasi Greg nuk e ka pasur fare të lehtë të mësohet pa mamin e tij. "Para, pas dhe më pas. Dita e parë e kopshtit: Duruam vetëm 1 orë e 45 minuta, nga të cilat 30 minuta ngjitur pas mamin. Gati për të përmirësuar kohën në ditët në vijim. Po fëmijëve tuaj sa kohë u është dashur që të përshtaten me situatën e re? Me të lehta kujtdo që e ka çerdhen apo kopshtin për herë të parë",-ka shkruar Julka krahas fotove të djalit të saj.



Ikën papritur Orinda Huta, ku do të shkojë?

Largimi i Turjan Hyskos nga "Vizion Plus" ishte një lajm i papritur për të gjithë. Ai së bashku me aktorët e "Apartamenti 2x1" u larguan drejt televizionit "Klan" për të shfaqur aty emisionin e humorit "Duplex". Por duket se pas tij në këtë televizion do të zhvendoset edhe bashkëshortja Orinda Huta, e cila po përfillet për largimin nga 'Vizion Plus', televizioni ku punon prej vitesh. Sipas burimeve të "Gazetës Express" Orinda do të jetë këtë sezon televiziv në 'Klan' dhe pikërisht në jurinë që do të gjykojë artistët e rinj në festivalin e muzikës së lehtë shqiptare "Kenga Magjike 2018". Orinda ishte moderatore dhe autore mjaft e rëndësishme e disa programeve në "Tring" dhe "Vizion Plus"./revistawho.com



KESHILLA

Puna që kërkon të qëndroni ulur për një kohë të gjatë jo vetëm që shkakton dhimbje në pjesën e poshtme të shpinës, por edhe rrit rrezikun nga kanceri dhe sëmundjet e zemrës, kanë treguar dy studime të reja amerikane.

Lajmi i mirë është që dhimbjeve të shpinës dhe pa-sojave më të këqija shëndetësore megjithatë mund t'u vihet fundi, dhe kjo me vetëdisiplinë në vend të punës. Çdo një orë çohuni nga karrigia dhe të paktën për pesë minuta bëni çka do, përveç se të qëndroni ulur. Shkuarja në tualet, marrja e një gotë ujë, shëtitja nëpër shkallë apo rreth ndërtesës janë hapat e parë në drejtim të përmirësimit të shëndetit. Do të ishte e shkëlqyeshme që çdo disa orë në punë të bëni disa ushtrime të zgjatjes. Por me e rëndësishme është, theksojnë mjekët, që pas punës të mos vazhdoni të qëndroni gjatë tërë mbremjes para televizorit.

Sa më aktiv të jeni në kohë të lirë, më të shëndetshëm do të jeni, thonë mjekët. E njëjta vlen edhe për ata të cilët ditën në punë e kalojnë në këmbë.

Femrat, të cilat qëndrojnë ulur nga tetë orë në ditë kanë rrezik më të madh nga zgjerimi i venave të gjakut.

Ushtrimet rekomandohen edhe për sëmundjet më të përhapur të njeriut modern, të punësuar - stresin.

Nëse ai është kronik, truri nxit sekrecionin e rritur të hormonit të kortizolit dhe noroadrenalinës. Disa nga pasojat janë shtrësat e akumuluar rreth belit, tensioni i rritur i gjakut, rreziku më i madh nga sëmundjet e zemrës.

Çfarëdo aktiviteti fizik do të zvogëlojë prodhimin e atyre hormoneve dhe do të relaksojë muskujt. Por, megjithatë rekomandohen ushtrime më intensive, siç është vrapimi. Ndihe e madhe në luftë me stresin është edhe dëgjimi i muzikës, sepse zvogëlon tensionin dhe numrin e rrahjeve të zemrës, thonë mjekët.

MOS U KËRRUSNI KUR SHTYPNË NË TELEFON

Kërrusja gjatë shikimit në telefon po ashtu mund të ketë pasoja të rënda në qafë dhe në shpinë. Prandaj më së miri është që pajisjet të mbahen në nivel të syve për të qëndruar trupi në pozitë sa më të drejtë, thonë mjekët.



Shmangni pasojat negative të qëndrimit ulur



SHTRESAT ERGONOMIKE PËR TASTIERË DHE MAUS RUAJNË NYJAT

Ata të cilët shtypin shumë në tastierë duhet të marrin bazën ergonomike për tastierë dhe maus, e cila i lodh më pak nyjat. Pauzat e shpeshta po ashtu janë të domosdoshme, veçanërisht për femrat gjatë menstruacioneve, sepse atëherë grumbullohet më shumë ujë në nyje, çka krijon

shrypje në to. KUR I NGRINI FËMIJËT, NDIHMOJENI VETËN ME KËMBË

Edukatoret shpesh duhet t'i ngrenë fëmijët, çka mund të jetë shkak për dhimbjet në krahë dhe në shpinë. Mjekët u rekomandojnë edukatoreve në kopsht dhe nënave që derisa mbajnë fëmijët apo ndonjë barër tjetër, ta kalojnë peshën edhe në këmbë. **USHQIMI NË SHTEPI**

SHPËTON

Njerëzit, të cilët punojnë në ndërrime të natës vuajnë më shpesh nga sindroma e irritimit të zorrëve se ata që punojnë ditën.

KARRIGIA NUK ËSHTË E PARREZIKSHME

Nëse në punë rri në këmbë dhe ecni shpesh, jeni më të mbrojtur nga sëmundjet e zemrës dhe nga trashësia për dallim prej atyre që qëndrojnë në karrige.

FUNDJAVA ËSHTË E REZERVUAR PËR MBUSHJE ME ENERGJI

Nëse punoni në ndërrime të natës, është e rëndësishme që gjatë ditës të flini 7-8 orë të mira. Për të krijuar kushte të mira për gjumë, uleni temperaturën e dhomës, lëshoni roletat, dhe vendosni tampona/tapë në veshë. Po ashtu gjatë ditëve të lira flini sa më shumë që mundeni.

Blloku apo Lungomare? Krahasimi i veçantë që gjen Rama

Kryeministri Edi Rama duket se po e shijon në maksimum Lungomaren në Vlorë. Ai e krahason atë me Bllokun në Tiranë. "Lungomarja e Vlorës, ka nisur të bëhet vija më e gjatë e lokaleve dizajn në Shqipëri - mua Blloku në krahasim me të, më duket si Ligue1 në krahasim me Premier League", shprehet Rama. Lungomare është një nga veprat e tij më të rëndësishme në Vlorë, ku është edhe deputet.



Andis Harasani i shkruan Ronaldos: Pas një viti të rikthehet fati

Ish-deputeti socialist, Andis Harasani, komentoi shterpësinë e Kristiano Ronaldos në Seria A, ku ende nuk ka gjetur rrugën e rrjetës. Harasani ka gjetur dhe shkakun se përse Ronaldo ende nuk ka shënuar gol. Sipas tij shkak është bërë fotoja me kryeministrin Edi Rama. "caro Kristiano, mos u merzit. E kam kaluar vetë. Një vit pas takimit me të, të rikthehet fati", shkruan z.Harasani.

**Caro Kristiano - mos u merzit.
E kam kalu vete. Nje vit pas
takimit me te, te rikthehet fati!**



BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

POLITIK



Gjiknuri i ankohet vlonjatëve: Nuk po na lini rehat të pushojmë...

Jo më kot "njerëzit e interesuar nuk na lënë rehat të pushojmë", thotë ministri Damian Gjiknuri. Mesazhin që ta lënë rehat, e ndau me vlonjatët në televizionin lokal "6 plus 1" të Vlorës. "Unë pushimet si gjithmonë i bëj në zonën e bregut, pasi që i vogël e kam pëlqyer shumë bregdetin e Vlorës. Kemi dhe anën tjetër në politikanët, me atë në thonjeza famën që kemi, në qoftë se do të quhet e tillë, që nuk na lënë dhe rehat të pushojmë. Se kudo që shkon do takosh një mik, një njeri të interesuar, fatkeqësisht ai tjetri mendon shqyrr që i erdhi rasti dhe nuk pyet për pushimet e tua. Mërzitësh dhe me njerëzit e familjes që më thonë ke ardhur për punë apo për pushime. Ne kemi nevojë që të kalojmë sa më shumë kohë me familjen, që të rikuperojmë mungesat e vitit",-tha Gjiknuri.



Kate dhe Meghan s'duhet të veshin rroba ngjyrë portokalli...

Në familjen mbretërore ka kaq shumë zakone dhe tradita që duhen zbatuar me saktësi nga secili pjesëtar i saj. Të gjithë e dinë se Meghan Markle pëlqen që veshjet e saj të jenë me tone neutrale, por me raste preferon edhe ngjyrat më të theksuara. Po Kate Middleton? Veshjet e saj janë të mbushura me ngjyra të ndryshme, nga e kuqja, blu, gjelbër e të tjera. Por asnjeren nga femrat e familjes mbretërore nuk e keni parë të veshë rroba me ngjyrë portokalli. Dhe e dini pse? Sepse e kanë të ndaluar që të dalin në publik me veshje të kësaj ngjyre. Rregullit fshihet nga një traditë 300-vjeçare dhe arsyeja se pse është vendosur është paska e çuditshme. Portokallia nuk del asnjëherë bukur në foto dhe duhet të shmanget me çdo kusht. Fakt qesharak! Por teksa Kate dhe Meghan e kanë të ndaluar një gjë të tillë, Mbretëresha e ka veshur pikërisht ngjyrën që nuk del bukur në foto.



SITUATA NE RAJON ZHVILLIMET

Në shtator vendimi, replikat e ndërkombëtarëve për shkëmbimin e territorit


Kufiri Kosovë-Serbi, The Guardian: Në zjarr nga të gjitha anët

Vuçiç do takojë Putin, Rusia kundër njohjes

Edhe pse kanë mbetur vetëm disa javë nga takimi i presidentit Aleksandër Vuçiç me atë të Kosovës, Hashim Thaçi, nuk kanë të reshtur debatet lidhur me diskutimin e kufirit Kosovë-Serbi. Ndërkaq një reagim e ka pasur edhe gazeta e njohur "The Guardian", e cila ka shkruar një artikull rreth korrigitimit potencial të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë, si ide për normalizimin e marrëdhënieve midis këtyre dy vendeve. Gazeta britanike ka theksuar se përkundër faktit se qëndrimet amerikane kanë ndryshuar gjatë administratës së fundit, ideja për riorganizimin të kufijve është duke hasur në kundërshtime si brenda edhe jashtë Ballkanit. Plani për t'i ridefinuar kufijtë e Kosovës është duke u përballur me një mori kritikash brenda republikës, rajonit dhe më gjerë. Presidenti kosovar, Hashim Thaçi dhe homologu i tij serb, Aleksandër Vuçiç kanë sugjeruar se një shkëmbim territoresh mund të jetë pjesë e një marrëveshjeje që do të hapë rrugën për një zgjidhje përfundimtare midis Beogradit dhe Prishtinës. Thaçi dhe Vuçiç janë takuar rrëgjilsh nën patronazhin e shëfës për politikë të jashtme të BE-së, Federica Mogherini, për të arritur një marrëveshje që mund t'i jap Kosovës një ulësë në OKB dhe t'i vendos të dyja vendet më afër BE-së. Megjithatë as Thaçi dhe as Vuçiç nuk i kanë bërë të ditura akoma detajet e planeve të tyre. Në një diskutim të mbajtur në Austri gjatë javës së kaluar, të dy kanë pohuar se ndryshimet kufitare ishin pjesë e diskutimit. Një ndryshim ndoshta do të përfshinte shkëmbimin e territorit të Serbisë jugore, kryesisht të populluar nga shqiptarët etnikë, për pjesën e Kosovës veriore me një popullsi kryesisht etnike serbe. Këshilltari për Siguri Kombëtare i Shteteve të Bashkuara, John Bolton, së fundmi ka deklaruar se Washingtoni nuk do të qëndronte në rrugë nëse Beogradi dhe Prishtina arrijnë një marrëveshje, duke përmbytur një politikë disaveçjare të ShBA-ve që vlerësohte se ndryshimet e mëtejshme kufitare në Ballkan janë të papranueshme. Vuçiç është



PARLAMENTI
Kosova pritet të mbledhë sot parlamentin, në një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar mbi angazhimet e presidentit të Kosovës, për korrigjimin e kufijve në dialogun në mes Kosovës dhe Serbisë. Njoftimi është bërë nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ndërsa seanca pritet të mbledhet ditën e nesërme në orën 10:00. "Nesër do ta kemi seancën e jashtëzakonshme, komentet politike do t'i kemi nesër në seancë", -u shpreh Veseli.



Parlamenti i Kosovës

"THE GUARDIAN"

Përkundër faktit se qëndrimet amerikane kanë ndryshuar gjatë administratës së fundit, ideja për riorganizimin të kufijve është duke hasur në kundërshtime si brenda edhe jashtë Ballkanit. Plani për t'i ridefinuar kufijtë e Kosovës është duke u përballur me një mori kritikash brenda republikës, rajonit dhe më gjerë.



Vuçiç: Të largojmë urrejtjen 200-vjeçare mes serbëve dhe shqiptarëve

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka thënë se serbët dhe shqiptarët duhet njëherë e përgjithmonë ta largojnë urrejtjen 200-vjeçare mes tyre dhe të gjejnë gjuhë të përbashkët për normalizimin e raporteve. Megjithatë, presidenti serb nuk ka dhënë detaje lidhur me debatet për korrigjimin dhe shkëmbimin e territoreve me Kosovën. Vuçiç ka thënë se është shumë e vështirë që të arrihet një zgjidhje, por se e ka shumë të rëndësishme që të mbetet e shkruar ajo se çfarë kemi mundur të kemi dhe se gjithçka që ka folur e bërë do të shkruhet në histori. "Të gjithë më pyesni për kufijtë, por unë po ju pyes juve, për cilin kufi po flisni? Ne themi se Kosova është Serbi, ndërsa ata thonë se Kosova është e pavarur. Në këtë situatë secili e vendos kufirin e vet. Por, a na duhet kjo? Ne jemi të këtij vendi dhe duhet që bashkë të vendosim për një kufi duke larguar kështu njëherë e përgjithmonë urrejtjen 200-vjeçare mes një serbi dhe një shqiptari. Ne jetojmë këtu dhe ne duhet të merremi vesh si duam të jetojmë dhe jo dikujt tjetër t'i plotësojmë dëshirat", është shprehur Vuçiç. Ai dhe kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev në vendkalimin kufitar mes dy vendeve, në Tabanoc afër Kumanovës përruan një pikë të përbashkët doganore. Projekti "One Stop Shop" parashikon që automjetet me mallra dhe mjetet tjera transportuese, t'i nënshtrohen vetëm njëris pikë doganore, duke lehtësuar kështu procedurat e kontrollit. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev tha se mbështet çfarëdo zgjidhje që do të arrijnë dy vendet e që do të ishte në drejtim të garantimit të paqes dhe stabilitetit jo vetëm në Kosovë e Serbi, por edhe më gjerë në rajon.

Ministri për Europën e Gjermanisë, Michael Roth, paralajmëroi të hënën Kosovën dhe Serbinë se ndryshimi i kufirit të tyre nuk do të zgjidhë asnjë problem dhe tha se e ardhmja e rajonit është multietnike, multifetare dhe multikulturore. "Të dashur miq në Kosovë dhe Serbi, rishkrimi i kufijve nuk do të zgjidhë asnjë problem. Një veprim i tillë do të hapte Kutinë e Pandorës të armiqësive etnike. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është thjesht multietnike, multifetare dhe multikulturore. E bash-

Ministri gjerman: Ndryshimi i kufirit Kosovë-Serbi hap kutinë e Pandorës



kuar në diversitet, kjo është Europa", tha Roth në një postim në "Twitter".

MICHAEL ROTH:
"Të dashur miq në Kosovë dhe Serbi, rishkrimi i kufijve nuk do të zgjidhë asnjë problem. Një veprim i tillë do të hapte Kutinë e Pandorës të armiqësive etnike. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është thjesht multietnike, multifetare dhe multikulturore. E bashkuar në diversitet, kjo është Europa", -tha Roth në një postim në Twitter.

duke u përballur me shumë kundërshtime në Serbi pasi që disa e shohin një marrëveshje të tillë si pranim se Kosova është e humbur përgjithmonë. Gjithashtu, ka kritika të forta brenda Kosovës, veçanërisht nga kryeministri Ramush Haradinaj, i cili i referohej kësaj ideje si "ide katastrofike". Kancelarja gjermane, Angela Merkel, e ka kundërshtuar një ide të tillë dhe tre ish-përfaqësues të lartë të Bosnjës i kanë dërguar një letër Federica Mogherini duke i kërkuar asaj të

mos mbështesë ndonjë plan që përfshin shkëmbim territoresh. "Ne mund të themi se nuk mund të mendojmë për ndonjë politikë që ka më shumë gjasa të na çojë në ndarje dhe konflikt të Ballkanit sesa ai që tani po mbështetet nga disa", shkruhej në letërën e Carl Bildt, Pedi Eshdaun dhe Kristian Shvarc-Shilling. Megjithatë, ka frikë se thjeshtë duke e vendosur këtë çështje përsëri në tavolinë, do t'i nxitë ata që dëshirojnë të rihapin temat që tashmë janë të zgjidhura. Në

Maqedoni jetojmë një numër i madh shqiptarësh dhe ishte skenë e përplasjeve ndëretnike gjatë vitit 2001. Politikanët kanë qenë të kujdesshëm për çdo marrëveshje që përfshin shkëmbim territoresh. Një tjetër çështje kyçe është edhe Rusia. Vuçiç pritet të takojë dy herë presidentin rus Vladimir Putin në muajt e ardhshëm dhe deri më tani Moskë ka dhënë pak shenja se a është gati të heqë kundërshtimin e saj të gjatë për pavarësinë e Kosovës.



Partitë pro-serbe në Mal të Zi, anëtare të Frontit Demokratik të opozitës, së bashku me Këshillin Kombëtar Serb, thanë se do të nisnin këtë javë mbledhjen e nënshkrimeve për anulimin e vendimit të Malit të Zi për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Nisja e peticionit u paralajmërua nga Partia Popullore Demokratike, anëtare e Frontit Demokratik, anëtarët e së cilës, nën udhëheqjen e kryetarit Millan Knezheviq, vizituan të dielën Mitrovicën e Veriut, me ftesë të kryetarit të këtij qyteti, Goran Rakicq. Partia Popullore Demokratike tha se "së paku 85% e qytetarëve të Malit të Zi nuk e mbështesin njohjen e rreme të shtetit të Kosovës", raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropë e Lirë. Mali i Zi e ka njohur Kosovën tetë muaj pasi ajo ka shpallur pavarësinë, përkatësisht në tetor të 2008-ës.

Partia Popullore Demokratike: Janë 85% kundër pavarësisë

Pro-serbët në Mal të Zi mbledhin nënshkrime për të anuluar njohjen e shtetit të Kosovës



Kreu i Partisë Demokratike në Mal të Zi

PARTIA POPULLORE DEMOKRATIKE: "Së paku 85% e qytetarëve të Malit të Zi nuk e mbështesin njohjen e rreme të shtetit të Kosovës", raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropë e Lirë sipas fjalëve që tha partia Popullore Demokratike.

Më 30 shtator mbahet referendumi, grekët 'ndizen' në protesta

Angela Merkel, Kancelarja e Gjermanisë, të shtunën do të qëndrojë për vizitë në Shkup, ku pritet të takohet me kryeministrin Zoran Zaev. Lajmi është bërë i ditur nga zëdhënësi i saj Shtefen Zajberg, publikoi agjencia greke e lajmeve ANA-MPA. Siç raporton korrespondentja e MIA-s nga Athina, në tekstin e shkurtër, ANA-MPA transmeton deklaratën e zëdhënësit të Kancelares, i cili thotë se Merkel dëshiron që të krijojë përshtypjen e saj, duke ardhur në Maqedoni, në prag të referendumit. "Ende po punohet për programin, por mund të them se Kancelarja do të takohet me kryeministrin IRJM-së, Zoran Zaev", deklaroi Zajberg dhe shtoi se në fokus të takimit do të jenë "ngjarjet rajonale, temat bilaterale", ndërsa zonja Merkel "gjithsesi që të dëshiron në vetë vendin e ngjarjes të krijojë përshtypjen e saj për referendumin lidhur me emrin e vendit, i cili do të mbahet në fund të muajit", transmeton agjencia greke e lajmeve. Ndërkaq, afrimi i 30 shtatorit, ditës së referendumit që do të mbahet në Maqedoni për të aprovuar ose jo marrëveshjen me Greqinë për emrin, ka rritur përsëri reagimet e grekëve, sidomos në zonat veriore të vendit. Shumica e protestave të javës që vjen në Selanik dhe qytetet e tjera rreth tij janë ato të organizuara nga grupe që kundërshtojnë marrëveshjen që nënshkruan Athina dhe Shkupi në Prespë, disa muaj më parë. Reagimet që ishin shuar gjatë muajve të verës filluan përsëri të përshkallëzohen, sidomos pas deklaratave të ministrit të Jashtëm, Nikola Dimitrov, në Parlamentin

Angela Merkel takim me homologun Zoran Zaev ditën e shtunë

Zëdhënësi i Kancelares gjermane: Ja ç'do diskutohet



Kancelarja Merkel dhe homologu Zoran Zaev

30

SHTATOR:

Është shpallur referendumi për emrin, në të cilin, konform me vendimin, të cilin Kuvendi e votoi në 30 korrik, qytetarët e Maqedonisë më 30 shtator. Vendimi u votua pa praninë e deputetëve të opozitës OBRM-PDUKM.

SHTEFEN ZAJBERG:

"Merkel dëshiron që të krijojë përshtypjen e saj, duke ardhur në Maqedoni, në prag të referendumit. Ende po punohet për programin, por mund të them se Kancelarja do të takohet me kryeministrin Zoran Zaev. Në fokus të takimit do të jenë ngjarjet rajonale, temat bilaterale, ndërsa zonja Merkel gjithsesi dëshiron të jetë në vetë vendin e ngjarjes, të krijojë përshtypjen e saj për referendumin lidhur me emrin e vendit, i cili do të mbahet në fund të muajit", -ka thënë



EMRI I MAQEDONISË, MARRËVESHJA:

Në 12 qershor është arritur marrëveshja mes Maqedonisë dhe Greqisë për çështjen e emrit. Gjatë një deklaratë për mediat, kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev tha se duke nisur nga sot Maqedonia do quhet "Republika e Maqedonisë së Veriut".



PSE REFERENDUM?

Në fund të muajit qytetarët do duhet të prononcohen për pyetjen: "Nëse jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranimin e Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?" Për zbatimin e referendumit tashtmë është funksionale edhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ).

European. I pyetur nga eurodeputetët konservatorë të Greqisë, ai ka theksuar se "vendi i tij do të quhet Republika e Maqedonisë Veri-

ore dhe qytetarët e saj do të jenë maqedonas, të cilët do të flasin gjuhën maqedonase". Janë pikërisht gjuha dhe identiteti, dy nga pikat

kryesore të kësaj marrëveshjeje, që për një pjesë të konsiderueshme të grekëve nuk pranohen. Në shtypin e djathtë grek riprodhohen dek-

laratat e fundit, por edhe të mëparshme të kryeministrit Zaev, në të cilat ai thekson ato çfarë fiton vendi i tij me këtë marrëveshje, ndaj dhe kërkon nga bashkëqytetarët e tij pjesëmarrje në referendumi dhe aprovimin e saj. Sondazhi i disa ditëve më parë tregoi se, 57% e të intervistuarve janë shprehur se do të votojnë pro marrëveshjes, e cila do të sjellë integrimin e vendit në NATO dhe BE, e ky rezultat ka shkakuar buzëqeshje në Shkup. Ndërsa në Athinë, ministri i Mbrojtjes, njëkohë-

sisht kreu i partisë së aleancës qeveritare "Grekët e Pavarur", ka paralajmëruar menjëherë pas riformatimit të kabinetit që ka bërë kryeministri Tsipras se do ta rrezojë qeverinë, nëse marrëveshja vjen në Parlamentin grek, duke mos e aprovuar atë.

Opinion i Ditës

Për psikologë shkollorë dhe mësues më të mirë

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

... më mirë, mjedise më miqësore për nxënie dhe edukim, dëshirë e justifikuar për të vijuar studimet e larta etj. Sidoqoftë, pavarësisht punës dhe qëllimeve të mira, mbeten shumë për të bërë, veçmas, puna në fakultetet e mësuesisë për të ndihmuar studentët të bëhen psikologë shkollorë dhe mësues më të mirë.

Në një nivel të lartë abstragimi, është lidhja mes zhvillimit psikik të njeriut dhe procesit të nxënies, ajo që na nxit të studiojmë formimin universitar të psikologut shkollorë dhe mësuesit. Besojmë se cilësia e këtij formimit ndikon më pas, bashkëpunimin e tyre profesional në mjediset arsimore në dobi të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve.

Psikologu shkollor, i mbështetur nga pedagogët për të ndërtuar njohuritë dhe kompetencat profesionale, ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kenë sukses në shkollë e shoqëri, në zgjidhjen e problemeve emocionale dhe të sjelljes. Ai bashkëpunon me mësuesit, prindërit dhe profesionistët e tjerë për të lehtësuar procesin e nxënies dhe për të forcuar lidhjet shtëpi-shkollë-komunitet për të gjithë nxënësit. Ai, gjithashtu, përmes bisedave e trajnimeve, ndihmon mësuesit për të kuptuar thellë karakteristikat e zhvillimit moshor të nxënësve dhe problemet tipike që hasin ata gjatë nxënies. "Psikologët e shkollave trajnohen në psikologji dhe në edukim, për të ndihmuar fëmijët të jenë të suksesshëm në aspektin akademik, social dhe emocional" thekson Shoqata Kombëtare e Psikologëve Shkollor (NASP), e cila përfaqëson më shumë se 25.000 psikologë shkollorë, studentët të diplomuar dhe profesionistët, në ShBA dhe 25 vende të tjera.

Në anën tjetër, mësuesi, për të qenë i suksesshëm, krahas njohurive dhe kompetencave profesionale në disiplinën përkatëse, duhet ndihmuar që në fakultet të arrijë kuptimin e faktorëve psikologjikë që promovojnë mirëqenien mendore e fizike të nxënësve dhe lehtësojnë nxënien, si proces dhe produkt. Studimet provojnë se sistemet arsimore bashkëkohore janë mjaft komplekse; se nuk ka një qasje për nxënien që funksionon njëjloj për të gjitha subjektet; se nxënia është përpjekje vetjake e përijetshme, rezultat i ndërveprimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm; se njerëzit nxënë jo vetëm në shkollë; ata nxënë në punë, në situatat shoqërore; madje, nxënë edhe kur bëjnë punë të thjeshta si ato të shtëpisë.

Janë këto arsyt që na shtynë të studiojmë disa elemente të formimit universitar pedagogjik të psikologëve dhe formimin



psikologjik të mësuesve; njëherazi, bashkëpunimin profesional mes tyre. Analizuar planet mësimore të fakulteteve në Universitetin e Tiranës (UT) dhe Universitetin "A. Xhuvani" që përgatitin psikologë shkollorë dhe mësues. Të ndihmuar nga DAR Tiranë, mbledhëm të dhëna nga 35 psikologë të shkollave të qytetit të Tiranës ("psikologë", pasi të gjitha janë femra) dhe 54 mësues të shkollave "De Rada", "Pjetër Budi", "Kongresi i Lushnjës" dhe "Fan Noli".

Nga analiza e dokumentacionit kurrikular, rezultoi se në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT, për formimin pedagogjik të psikologut ofrohet 10% e totalit të krediteve, vetëm në ciklin e studimeve Master ("Kurrikula shkollorë", "Teoritë e të nxëniet dhe modelet e mësimdhënies dhe "Vështirësitë në të nxënë"). Ndërsa, në planin mësimor në Fakultetin e Universitetit "A. Xhuvani" ofrohet vetëm 7% e krediteve ("Psikologji zhvillimi", "Psikolinguistikë dhe metodologji e mësimit të gjuhës së huaj"). Dallime të ndjeshme kanë disiplinat që fakultetet u ofrojnë psikologëve të ardhshëm për formimin e tyre pedagogjik.

Dallime dhe kufizime konstatohen në planet mësimore të fakulteteve që përgatitin mësues. Në programin "Master shkencor në mësuesi", Departamenti i gjuhës gjermane, UT, formimit psikologjik të mësuesit i kushtohet

9% e krediteve ("Psikologji zhvillimi" dhe "Psikolinguistikë dhe metodologji e mësimit të gjuhës së huaj"); në programin "Master Shkencor Mësues i Matematikës për Arsimin e Mesëm të Lartë", UT, këtij aspekti i kushtohet 4.1% e krediteve (Psikologjia e zhvillimit); në programin "Master profesional në Mësuesi në AMU për Matematikë - Fizikë", Universiteti "A. Xhuvani" ofrohen 9.5% ("Hyrje në Psikologji", moduli: "Psikologji Edukimi"; moduli: "Psikologji Zhvillimi"). Edhe këtu, vërehen dallime ndërmjet disiplinave që fakultetet u ofrojnë studentëve për formimin e tyre psikologjik.

Me interes janë gjetjet nga vlerësimet që kanë psikologët për mësuesit dhe anasjelltas. Sa u takon psikologeve në qytetin e Tiranës, moshë mbizotëruese luhatet në kufijtë 31-40 vjeç (83%), sakaq mbizotëron diploma "Master i shkencave" (70%). Përgjithësisht, ato janë të kënaqura nga bashkëpunimi me mësuesit; ndërkaq, vetëm 48% i renditin saktë aspektet kurrikulare që burojnë nga formimi pedagogjik i psikologut; 97% deklarojnë se "formimi im akademik nuk është i plotë në aspektin arsimor". Më tej, 96% shprehën që "kultura psikologjike e mësuesve nuk është e plotë"; sikundër, 73% e tyre shprehën se "në bibliotekë e shkollës nuk ka literaturë

psikologjike që më ndihmon për zhvillimin profesional".

Target grupi i mësuesve të anketuar mbizotërohet nga moshat mbi 41 vjeç (61%). Mbizotëron diplomimi në programin e studimeve "Master i shkencave" (60%). Vetëm 33% raportojnë renditje të saktë të elementeve të nxënies që ndikohen nga formimi psikologjik. 50% e mësuesve kërkojnë të ndihmohen më shumë nga psikologjia e shkollës në shpjegimin e përmbajtjes lëndore me nxënësit; ndërsa, 62% kërkojnë të asistohen më mirë në përgatitjen e nxënësve për testime. Edhe pse psikologët raportojnë se kryejnë vëzhgime në orë e mësimi, 67% e mësuesve nuk mendojnë kështu. 76% e mësuesve mendojnë se në shkolla duhet të ketë më shumë literaturë që përmirëson kulturën psikologjike.

Nga analiza e të dhënave të siguruar, rezultoi se formimi pedagogjik i psikologut dhe ai psikologjik i mësuesit nuk sigurojnë ndërtimin e njohurive dhe të kompetencave të nevojshme profesionale me të cilat mund të përmirësohet cilësia e nxënies. Kështu, psikologët deklaruan se "formimi pedagogjik nuk u mundëson të ndihmojnë sa e si duhet mësuesit dhe nxënësit për metodat, teknikat dhe instrumentet që mund të përdoren në kontekstin e nxëniesve formale apo informale". Mësuesit, nga ana e

tyre, konstatojnë se "në fakultete nuk janë trajnuar si duhet për të njohur teoritë kryesore psikologjike dhe teknikat efektive që ndihmojnë kuptimin dhe adresimin e sfidave që ndesh subjekti gjatë nxënies".

Përfundimet nga studimi ripohojnë nevojën e përbaljes nga universitetet të sfidave për formimin e psikologut shkollor dhe të mësuesit. Pjesë e tyre janë përmirësimet në kurrikulat universitare për të ofruar më shumë kohë dhe trajnim cilësor në dobi të identifikimit dhe studimit të metodave efikase të nxënies, për të kuptuar më mirë se si fëmijët dhe të rinjtë ndërtojnë, ruajnë dhe përdorin kuptimet dhe kompetencat që ndërtojnë. Në këtë kontekst, psikologët shkollorë, si njohës të teorieve psikologjike të zhvillimit njerëzor, duhen ndihmuar të kuptojnë karakteristikat e nxëniesve individuale dhe të informojnë mësuesit për ndërtimin efikas të procesit të nxënies. Dy grupet e profesionistëve, përmes bashkëpunimit, mund dhe duhet të thellojnë njohjet se si realizohet nxënia nga subjektet në mjediset të ndryshme, përmes qasjeve dhe strategjive që e bëjnë atë më efektive. Në këtë kuptim, si formimi universitar, ashtu dhe bashkëpunimi profesional në mjediset e shkollës, bëhen pjesë e rëndësishme e ndryshimit që synojmë.

Tiranë, më 02.09.2018


Opinioni **i** Ditës

Pse pushuam më qetë?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... plagosje apo vrasje nga krekosja e djemve të llastuar të ballarëve të pasur, që sillnin qëllimshëm motorët pranë atyre që laheshin duke përdorur krahët dhe këmbët mbi ujë. Ishim mbi 350 mijë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe nga Maqedonia, por edhe me dhjetëra mijëra polakë, italianë, serbë etj., që nuk përjetuam këtë tmerr për veten dhe sidomos fëmijët tanë, brigjeve të Jonit. Askush në Sarandë nuk u çu tejpërtej nga bashi i ndonjë motobarke të shtrenjtë. Lajmet gati makabre të turistëve të gjymtuar nga mjetet ujore i takojnë vetëm vitit të kaluar. Le të dalë dikush që udhëtoi këtë verë, nga Shëngjini deri në Butrint, dhe të thotë që mori një gjobë të pamerituar nga policë rrugorë "gjuajtës" xhepash të turistëve vendas dhe të huaj, sidomos atyre të huaj apo të shqiptarëve nga Kosova e Maqedonia. Këto shfaqje të shëmtuara, aq të shpeshta pak vite më parë, tani nuk janë më. Ata që erdhën në Shqipëri (dhe ishin rreth 160 mijë më shumë se periudha qershor-gusht 2017) nuk njohën ato radhë të gjata rraskapitëse në pikat doganore, të paktën për faj të palës shqiptare të kontrollit të dokumenteve dhe bagazheve. E kundërta ndodhi. Trageti italian nga Brindisi për në Vlorë, për shembull, i la qindra shqiptarë të prisnin me fëmijë të vegjël me orë të tëra në mol, pse duhej të bënte "taksistin" duke marrë turistë në brigjet e Korfuzit. Shqiptarët pritën që nga ora 2 e drekës (kohë kur bileta e shtrenjtuar që kishin prerë tregonte) deri në 9 të darkës, për të ardhur trageti i përdorur taksit Korfuz-Brindisi. Askush nuk pagoi ndonjë dëmshpërblim për këtë padrejtësi të shkaktuar qindra familjeve emigrante shqiptare. Askush nuk doli përgjegjës. Ndërkohë tek ne, në Shqipëri, turistët, sidomos ata të huaj, u vdhën më pak nëpër dhomat ku pushuan, apo në mjete publike e private të transportit që përdoren. Mos vallë patëm shumë hajdutë që hoqën dorë nga profesioni i tyre? Jo, nuk e mendoj kështu. E vërteta është se kemi pasur policë që patrullonin edhe civile ose nëpër biçikleta. Dhe kjo lë shenjë, sado të lehtë që të duket fillimisht. Lokalet, baret dhe restorantet në bregdet këtë vit na u dukën singjerisht më pak të zhurmshtëm se çdo vit tjetër dhe gjumi i prishur nuk kaploi me dhjetëra mijëra pushues, "faktorë" pse i kishin dhomat pranë këtyre restoranteve dhe hoteleve. Ndoshta ka punuar më së fundmi mirë edhe pushteti vendor, i pranishëm në disa zona bregdetare. Dhe të gjitha këto nuk janë pak për një turizëm hallemadh si i yni. Sigurisht, ju çdo gjë shkojë në vaj. Ato yje që u kemi vënë kot hoteleve tona në bregdet dhe që si-



domos për hapësirën që ofrojnë, nuk i justifikojnë fare, të paktën t'i shlyenim disa me mikpritjen shqiptare. Me mënyrën më profesionale dhe të ngrohtë të të sjellurit. Mikpritja ishte e gjitha aty, por nganjëherë, për fat të keq, tinzare dhe e fasadës. Shpesh turistët, si ata të huaj dhe vendas, u keqpër-

dorën dhe u keqtrajtuan nga tone zëri ironike ose të larta ofenduese. Shpesh ka pasur një sjellje aspak profesionale të atyre që merrnin paratë e shezlloneve në plazh, apo faturat e restoranteve dhe kafeneve. Patëm vërtet numër rekord më të madh turistësh nga përtej kufirit, por një numër gjithnjë e

më i madh qytetarësh me të ardhura të mesme dezertoiz plazhet tona dhe hotelet e dhomat e pushimit. Janë mbi 30-40 mijë. Këta na i mori Greqia fqinje, si dhe, si gjithnjë në këto 10 vitet e fundit, Turqia me Antalian e saj, por edhe Kroacia e Mali i Zi. Për këtë duhet të shqetësohemi dhe të shikojmë çfarë duhet bërë në këto 9 muaj deri në fillimin e sezonit të ri veror. Ta bëjmë më tërheqës bregdetin tonë dhe më pak zhgënjyes në shërbimet që ofrojmë. Duhet një punë e përbashkët qeveri qendrore-bashki bregdetare. Që duhet të fillojë që tani, në ditët e para të shtatorit e të përfundojë në maj 2019. Por të paktën, për këtë sezon turistik veror, një herë le ta falënderojmë me plot gojë policinë shqiptare që na dhuroi pushime më të qeta.

Ishim mbi 350 mijë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe nga Maqedonia, por edhe me dhjetëra mijëra polakë, italianë, serbë etj., që nuk përjetuam këtë tmerr për veten dhe sidomos fëmijët tanë, brigjeve të Jonit. Askush në Sarandë nuk u çu tejpërtej nga bashi i ndonjë motobarke të shtrenjtë. Lajmet gati makabre të turistëve të gjymtuar nga mjetet ujore i takojnë vetëm vitit të kaluar.

HOROSKOPI

DASHI

Shmangni një hap të nxituar në dashuri. Sot mund të ndiheni shumë në ankth gjatë gjithë ditës në punë. Dëshira juaj për të bindur të tjerët mbi një projekt do të rezultojë një dështim.

DEMI

Shmangni çdo investim afatgjatë dhe përpuni të dilni jashtë dhe të kaloni momente të këndshme me miqtë tuaj më të mirë. Një mysafir i padëshiruar mund t'ju marrë të gjithë kohën tuaj të lirë.

BINJAKET

Shëndeti do të jetë shumë i mirë pavarësisht nga një ditë plot tension. Burime të reja të ardhurash do të gjenorin përmes njerëzve që njihni. Kohë gëzimi me familjen dhe miqtë parashikohet ditën e sotme.

GAFORJA

Investimet janë të rekomanduara, megjithatë kërkoni këshilla të përshatshme. Fëmijët mund të sjellin disa lajme emocionuese. Edhe çështjet e dashurisë janë pozitive për ju.

LUANI

Duket se aktivitetet e shumta në punë ju kanë shkaktuar lodhje. Përpuni të kurseni para. Disa njerëz mund të bëjnë nervoz, thjesht injoroni ata. Do të jani shumë i ndjeshëm ndaj sjelljes së të dashurit tuaj. Lajme të mira parashikohen nga një vend i largët.

VIRGJERESHA

Çështjet e dashurisë kanë marrë të gjithë vëmendjen tuaj. Nëse një lidhje romantike nuk po ecën si duhet, nuk duhet të mërziteni. Yjet ju favorizojnë gjatë ditëve të ardhshme. Edhe financat parashikohen të mira.

PESHORJA

Ruani durimin tuaj si përpjekje e vazhdueshme për të garantuar suksesin tuaj. Mos lejoni anëtarët e familjes tuaj të vendosin se çfarë duhet të bëni apo nuk duhet të bëni sot. I dashuri juaj do të kërkojë përkushtim.

AKREPI

Ndjenja e pasigurisë dhe dezorientimit mund të shkaktojë probleme të ju. Miqtë do të jenë më mbështetës sesa ajo që parashikoni. Jini të kujdesshëm që të mos bëni komente të ashpër ndaj një kolegu.

SHIGJETARI

Aftësia juaj për të ndihmuar ata në nevojë do t'ju sjellë respekt. Jeta do të jetë me të vërtetë emocionuese kur bashkëshorti juaj do të vijë tek ju duke harruar të gjitha mosmarrëveshjet.

BRICJAPI

Sot do të ndiheni të lodhur dhe ka të ngjarë të jeni të mërzitur për çështje të vogla. Përpuni të kaloni një ditë të qetë me anëtarët e familjes. Sot do të ketë shumë çështje, të cilat kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme.

UJORI

Investimet e bëra sot do të rrisin prosperitetin tuaj dhe sigurinë financiare. Magjia që zotëroni dhe personaliteti juaj do t'ju ndihmojnë që të bëni disa miqësi të reja. Kujdesuni më shumë për veprimet dhe fjalët tuaja.

PESHQIT

Tensioni në vendin e punës mund t'ju bëjë të sëmurë. Disa çështje prona do të materializohen dhe do të sjellin përfitime të shkëlqyera. Ndihmoni partnerin tuaj në punë shtëpie për të zvogëluar ngarkesën e punës.

YLLI I BARCELONËS



Lionel Mesi nuk e priste largimin e Cristiano Ronaldos nga Spanja. Ndoshta i mësuar me pretendimet e vazhdueshme të portugezit, ai mendonte se kjo do të ishte një tjetër verë ku ai do të synonte përmirësimin e kushteve financiare. Ndaj argentinasi ka mbetur i çuditur kur Ronaldo bëri gati valixhet

Mesi: Nuk e prisja largimin e Ronaldos, tani Juvja është favorite për Champions

dhe u nis për në Torino ku iu bashkua Juventusit. "Nuk e imagjinoja larg Real Madrid e aq më pak e mendoja se mund të shkante te Juventus, pasi u fol për shumë skuadra por pak për bardhezinjtë. E vërteta është se isha shumë i

çuditur, por është gjithësi një skuadër e fortë", tha Mesi për "Catalunya Radio". Ai parashikon që ky transferim do të ndryshojë edhe hierarkinë e klubeve në futbollin evropian. "Pa Kristianon, Real Madrid do të jetë më pak i fortë, ndër-

sa Juventus do të bëhet një favorit i qartë për të fituar Ligën e Kampionëve. Ata kishin një skuadër të fortë, tani kanë edhe Cristiano Ronaldon", ishin fjalët e "Pleshtit" që ka humbur rivalin e tij të përjavshëm në La Liga.

Flet trajneri spanjoll që drejtoi bardheblutë. Jep këshilla për trajnerin dhe presidenti

Rubio: Halili po punon dhe mendon veç për Tiranën

Bordi drejtues i mohoi spanjollit projektin



Jeton Selimi

Hulian Rubio Sañchez, erdhi për herë të parë në Shqipëri në sezonin 2011-2012 te Tirana, si një emër i dëgjuar në futbollin spanjoll, madje ish-lojtar i spikatur dhe trajner te Sevija. I drejtoi me sukses bardheblutë, madje edhe pse në atë kohë me shumë ndryshime fitoi Superkupën. Nisi një projekt të madh, por që mbeti në letër edhe për shkak të drejtuesve të asaj kohe dhe bordit të "famshëm" të Tiranës që i vuri "shkopinj nën rrota" edhe pse presidenti Refik Halili e mbështeste dhe besonte shumë te spanjollit. Pas Tiranës, një aventurë të shkurtër edhe me Flamurtarin në Vlorë, por që nuk i eci dhe u desh që të rikthehej drejt Spanjës. E ndjek futbollin shqiptar dhe Tiranën e kujton me nostalgji duke folur për "Vip Sport".

A e ndjek Tiranën dhe futbollin shqiptar?

Unë jam profesionist dhe e ndjek futbollin nëpër botë. Jam rritur me futboll dhe sport. Futbollit shqiptar ishte fati im dhe unë e ndjek me shumë interes. Tirana ishte shtëpia ime, klubi im, unë do t'i jem mirënjohës gjatë gjithë jetës time.

Çfarë mendoni për Tiranën kur dy ndeshjet e para kanë marrë 1 pikë?

Kampionati sapo ka filluar, mos u shqetësoni, lojtarët e rinj janë punësuar dhe ekipi duhet të përshatet. Vetëm puna e përditshme dhe vetë konkurrenca do t'ju japin rezultate dhe klasifikim.

Çfarë mendoni për Ze Marian, trajnerin aktual të Tiranës?

Për trajnerin Ze Maria kam vetëm referenca të mira. Vitin e kaluar, ai ka arritur qëllimin e promovimit dhe këtë vit do të kthehet për të përmbyshur një sezon të suksesshëm.

A ke pasur kontakte me Halilin pas largimit nga



bardheblutë?

Unë kurrë nuk kam pasur kontakte me Refik Halilin. Por, jam shumë i sigurt se mendimet e tij janë të përqendruara vetëm për të mirën e skuadrës së Tiranës. Do të kisha dashur të flisja më shpesh. Unë edhe sot kam shumë dashuri, ai është një president i mirë dhe një person pozitiv.

Po për tifozët e Tiranës që ju kujtojnë me nostalgji edhe sot?

Unë dua t'iu dërgoj një përsëndetje të madhe tifozëve të Tiranës nëpërmjet portalit tuaj. Me tifozët bardheblu, unë mbaj një kontakt korrekt. Shpresoj se e kam përmbyshur qëllimin e tyre, por edhe dëshirën e tyre për të parë në fushë një skuadër shumë cilësore. Madje, nëse unë rikthehem në Shqipëri te Tirana, ata janë një arsye e madhe sepse me atmosferën që krijohet me kujtojnë rininë time kur

luaja dhe stadiumet ishin plot.

Po për eksperiencën e shkurtër me Flamurtarin?

Kam punuar dhe kam arritur trofe me Tiranën, është klubi i zemrës sime. Natyrisht që i jam shumë mirënjohës edhe Flamurtarit, sepse më ka mirëpritur me dashuri të madhe. Por, në përgjithësi, populli shqiptar më jep shumë ndjeshmëri, unë isha shumë i lumtur atje.

Çfarë mbresash ju ka lënë Shqipëria, duke qenë se kenit qenë mik në disa qytete?

Këtë verë, unë kam qenë në gjendje të kthehem në Superiorë, por nuk ka asnjë marrëveshje ekonomike me asnjë nga dy klubet që kanë biseduar me mua. Do të doja të kthehesha në Shqipëri, është një sfida që unë do të doja të plotësoja, sigurisht besoj se rikthimi do të jetë i shpejtë. Sulmuesi kuqezi, Sindrit Guri

vjen në kombëtare pas një forme të mirë në kampionatin belg, ku u transferua këtu vere nga Kukësi te Ostende. Tashmë i grumbulluar nga Panuçi, sulmuesi shkodran tha në konferencë për shtyp: "Sa i përket të kaluarës mendoj se ky është momenti më i mirë, por për të ardhmen kam shumë për të dhënë si për Kombëtaren ashtu edhe për klubin. Do të mundohem të jap më të mirën pasi ka të bëjë edhe fati por edhe si ta ndjekësh dhe unë do të jap maksimumin pasi e kam për detyrë".

ROSHI DHE SADIKU

"Më vjen keq për dëmtimet e Roshit dhe Sadikut pasi janë shokë ekipi dhe është negative si për kombëtaren ashtu edhe për djemtë pasi e ndjejmë që do rrinë 7 muaj larg fushave dhe është diçka negative. Roshi ka vendin e vet e Sadiku ka vendin e vet dhe unë do mundohem të

HULIAN RUBIO SAÑCHEZ

Dua t'iu dërgoj një përsëndetje të madhe tifozëve të Tiranës nëpërmjet portalit tuaj. Me tifozët bardheblu, unë mbaj një kontakt korrekt. Shpresoj se e kam përmbyshur qëllimin e tyre, por edhe dëshirën e tyre për të parë në fushë një skuadër shumë cilësore. Madje, nëse unë rikthehem në Shqipëri te Tirana, ata janë një arsye e madhe sepse me atmosferën që krijohet me kujtojnë rininë time kur luaja dhe stadiumet ishin plot

qetësi pasi nëse hyjmë në presion, është diçka negative".

SFIDA KUQEZI

"Nuk vij në Kombëtare për të bërë një xhiro, por në Kombëtare vij për të bërë maksimumin dhe për të ndihmuar ekipin e për të ecur sa më lart. Objektivi unë është të shënojim dhe fitojmë, por nuk ka rëndësi se kush shënon gol".

BELGJIKJA

"Futbolli në Belgjikë është shumë ndryshe. Por po filloj të përshattem, por trajneri dhe drejtori më kanë ndihmuar dhe kam luajtur që nga fillimi e kam qenë pjesë e skuadrës. Kam luajtur gdo ndeshje dhe nuk jam ndierë kurrë i ndarë nga skuadra. Duhet të përshattem më shpejtë dhe më shumë".

POZICIONI

"Roli im kryesor është sulmues qendër, pavarësisht kërkesave dhe mund të bëj çdo lloj roli për të ndihmuar ekipin. Aty ku më kanë blerë luaj si sulmues ndërsa te Kombëtarja do të luaj ku të dojë trajneri".

IZRAELI DHE SKOCIA

"Janë ndeshje shumë të rëndësishme dhe do japim maksimumin pasi nuk janë më miqësore dhe do të jemi më ndryshe. Janë ndeshje ku tifozët duhet të jenë prezentë dhe kur luan me tifozë, ke një peshë më të madhe dhe më shumë detyrim e besoj se do të jenë aty gjithmonë. Nuk duhet menduar më e kaluara, por duhet parë takimet me Izraelin dhe Skocinë. Duhet të mendojmë këto dy ndeshje dhe mos të shohim evropianin. Duhet të shohim afër njëherë, para se të shkojmë larg".

shfrytëzoj mundësitë e mia e të jap më të mirën".


RIVALITETI

"Unë mendoj se gjithsecili që ftohet në Kombëtare ka peshën dhe përgjegjësitë e veta dhe gdo kush do të fitojë, e ky është dhe synimi ynë. Gjithsecili do të marrë peshën e vet dhe të harrojmë miqësoret e të shohim nga ndeshjet që vijnë".

GOLI

"Goli? Sa më shumë e mendon, aq më keq është. Duhet mos ta mendojmë pasi vjen vetë. Sulmuesi ka presion pasi hyn vetvetiu pasi është një rol që, nëse themi se nuk kam presion, është gabim pasi mungesa e golit të bën keq. Duhet që lotari të jetë i qetë e të marrë ndeshjet një nga një. Edhe me trajnerin atje kam folur dhe më ka ndihmuar shumë duke qenë se ka luajtur vetë si sulmues. Nëse mungon goli 6-7 ndeshje duhet marrë me

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë detyrim që paguhet.
5. Ende është ndryshe.
10. Skuadër greke.
11. Agjenci Doganore Sarandë.
14. Duken të gjata në pritje.
15. Derek aktore.
16. Janë në modë.
18. Pak mefistoflike.
19. Inicialet e Mallë regjisor.
20. Entë Monituoruese Durrës.
22. Eshhtë e çuditura.
26. Në mes të Tommy dhe Jones aktor.
27. El Pibe de oro.
28. Janë punëtorë... marksistë.
30. Eshhtë cilësi.
31. Fillojnë ceremoninë.
32. Ngryesm me vërejtje.
33. E kundërta e zenitit.
36. Eshhtë poetik ai i poetit.

37. Power, ish- e Al Bano-s.
39. Muhammad i ringut.
41. Në fillim të vitit.
42. Eshhtë grindje.
46. Janë centralet si Chernobyl.
50. Thurin prapaskena.
51. Të fundit në tender.

VERTIKAL

1. Eshhtë edhe ajo e Mendelejevit.
2. Një erë kafeje.
3. Fillojnë tinëz.
4. Mbahet në polifoni.
6. Eshhtë më e vogël se bashkia një e tillë.
7. Të parat në orkestër.
8. Gibson aktor.
9. Eshhtë festive në festë.
11. Eshhtë si biskotë.
12. Shpërthejnë më polemika.
13. Janë si sprova.
17. Sulejmani ish-mesfushor.
21. Ulen në parlament.
23. Me Hajriën në balet.
24. Qyteti i FIAT.
25. Rastet pa set.
29. Një as i Real Madrid.
30. Skeda pa kufij.
31. Ishin ndjekësit e Antistenit.
34. Të parat në ambient.
35. Eshhtë gjigant përrallash.
37. Martin, regjisor i Norma Rae.
38. Eshhtë letër... kampion.
40. Luajnë pa ujë.
43. Hahen në kufij.
44. Inicialet e Redford.
45. Janë në digjë.
47. Diftong poetik.
48. Kufizojnë minutat.
49. Inicialet e Rohmer.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Hasi ish mesfushor.
5. Rrëngqethet nga frikat.
9. Fillojnë poshtë.
10. Janë në guvë.
12. Një hektar i shkurtër.
13. Një peshk i rëndë.
14. Një dog që hahet.
15. Qyteti i Scavolini-t.
18. Gjysmë fetare.
19. Janë regjimet dikaktoriale.
22. Fise pa fe.
23. Janë këngët me iso.
24. Shkaktojnë avari me punë armiqësore.
26. Fillojnë panikun.
27. Ishin ushtarët e Pirros.
28. Eshhtë filozofi e moralit.
30. Filoko aktor.
31. Rrallë është përgjysmë.
33. Një çmim i synuar nga kineastët.

HORIZONTAL


37. Ishte popull i tellallit.
39. Nuk qeshin.
42. Nuk ka amoma një bebe.
43. Janë poezi.
44. Një mbishkrim në kryq.
46. Fillojnë një temë.
47. Lidhen të parat.
48. Eshhtë injorantja e... akuzuar.

VERTIKAL


1. Fillojnë bashkë.
2. Një film publicitar.
3. Kush nuk di... mbytet.
4. Janë si kube.
5. Shkroi manifestin futurist.
6. Të parat në stadium.
7. Fillojë hollë.
8. Mund të jenë dhjamore të tilla.
11. Janë cilësi.
12. Janë drurët si pisha.
14. Eshhtë llogari që qërohet.
16. Qe poetja e Lesbos.
17. Eshhtë infeksion në vesh.
18. Janë indiane ato si sioux.
19. Qe komik i famshëm italian.
20. Inicialet e Kurosawa.
21. Mun të jenë ushtarake.
23. Merren nga kamerieri.
25. Eshhtë bota e lerule.
29. Një shëndeti në tubetë.
32. Me Buenos në Argentinë.
34. Shkurt për kompani.
35. Eshhtë e vogël në Anadoll.
38. Mbreti i Cordelia-s.
39. Eshhtë çelësi i violinës.
40. Luarasi aktore.
41. Një numër femrash.
45. Italia në Internet.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



SUDOKU

8				1		4	2
5							
	9		8	2	3		
		1		3		7	
					8		5
				5	9		
1	6			4	8		
				5		6	7
3	8		7		2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	8	3	6	9	4	2	1	5
9	2	6	1	3	5	7	4	8
4	1	5	7	8	2	9	3	6
8	3	1	9	2	6	4	5	7
2	5	9	4	7	8	1	6	3
6	4	7	3	5	1	8	9	2
3	9	4	2	6	7	5	8	1
1	7	8	5	4	3	6	2	9
5	6	2	8	1	9	3	7	4

Argëtim filozofik

- Pak njerëz kanë në natyrë këtë: të nderojnë pa zili mikun e tyre të lumtur.
- Miqtë janë si shalqini: për të gjetur një të mirë, duhen provuar disa.
- Nga gabimi në gabim dikush zbulon të gjithë të vërtetën.
- Kur thoni atë që dëshironi, të jeni të gatshëm të dëgjoni atë që nuk dëshironi.
- E kaluara ju jep një identitet dhe e ardhmja përmban premtimin e shpëtimt. Të dyja këto janë iluzione.

Thënie të mënçura

- Mos guaj me gur tek komshinjtë kur dritaret e tua i ke prej xhami.
- Sa më pak flisni, aq më shumë i'u dëgjojnë.
- Dashuria e vërtetë është e rrallë, miqësia e vërtetë është edhe më e rrallë.

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16		7	5	15	8		3	8		A	Z	O	V	E	T	N	A		B	A			
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12		Z	A	G	A	R	R	A		M	B	A	S	
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2		I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I		
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9	2			L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I		
		5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16			T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V	
4	8	6	5	2	15	8			7	15		10	7		M	A	R	T	I	N	A		E	N	K	E	
7	5	7			12	7	15		6	11	6	8	15		E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N		
5	6	4	7			5	2	18	2		11	19	7		T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E		
5	4	11	6	19					9	8	4	8	6		A	M	O	R	F	R	A		R	A	T	A	R
9	11	15			1	7	5	8		19	8	1	8		L	O	N	Z	E	T	A		F	A	Z	A	
7	6	2	14			14	7		16	11	15	7			E	R	I	C	C	E	V	O	N	E			
5	7	8	4			8	9	3	8	15	7	5			T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T		

- Fatit formon miqësi, ndërsa fatkeqësia e provon...
- Nëse kenë frikë nga vetmia, mos u martoni...
- Produktet e mira që njerëzit i duan, nuk kanë nevojë për teknika shije ose reklama në televizion. Merrni si shembull "barin".



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

DATA 03-13 Shtator 2018

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Adresa: Bulevardi Gjerqj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 055 20 16 816, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



www.gsh.al GAZETA SHQIPTARE



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

- Facebook: Gazeta Shqiptare
- Instagram: gazetashqiptare.al
- Twitter: Gazeta Shqiptare
- E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
- Youtube: Gazeta Shqiptare

